



RINIA E KOSOVËS

ME SYTE NGA E ARDHMJA
ME KEMBE NE TRADITA

H U L U M T I M 2 0 1 2



**FRIEDRICH
EBERT**

STIFTUNG



RINIA E KOSOVËS

ME SYTË NGA E ARDHMJA, ME KËMBË NË TRADITA

HULUMTIM 2012

Ekipi i Autorëve - IDRA:

Auron Pasha
Kreshnik Xhangolli
Jona Dundo
Besmir Gjokuta
Zana Tahiri
Odeta Lena

Konsulent: Dr. Klaus Hurrelman

ISBN: 978-9951-19-072-5

Viti i publikimit: 2012

© **IDRA Kosovë,**
www.idra.al, idra.kosova@idra.al

Përmbajtja

	Page
Parathënie.....	4
Përmbledhje.....	6
Hyrje.....	10
Pjesa sasiore.....	10
Pjesa cilësore.....	10
Pyetësi.....	11
Kampionimi.....	12
Familja dhe Jeta Shoqërore.....	13
Arsimi dhe Punësimi.....	32
Demokracia dhe Politika.....	45
Kosova dhe Integrimi në BE.....	53
Mënyra e jetesës dhe Koha e lirë.....	57

Parathënie

Dr. Klaus Hurrelman

Profesor i Shëndetit dhe Arsimit Publik, Shkolla e Qeverisjes Hertie në Berlin

Disa kohë më parë, lindi ideja, në bashkëpunim me fondacionin Friedrich Ebert, për të ndërmarrë një studim mbi të rinjtë në vendet ish-Jugosllave, duke ndjekur kështu shembullin e studimeve mbi të rinjtë të mbështetur nga Shell i cili është i mirënjohur dhe i lexuar gjerësisht në Gjermani. Duke intervistuar anëtarë të gjeneratës së re në një vend, është e mundur të marrësh informacion të vlefshëm mbi interesimet dhe dëshirat e adoleshentëve dhe të rinjve në atë vend. Por është më e thellë se kaq: qëndrimet e të rinjve dhe drejtimi i vlerave të tyre mund të konsiderohen një tregues i hershëm që shfaq prirjet e ardhshme mbizotëruese të një shoqërie. Për gjeneratën e re, sikurse kanë treguar në mënyrë të vazhdueshme edhe analizat tona në Gjermani, ky lloj studimi mund të konsiderohet si një sizmograf për sa i përket mundësive të ardhshme dhe perspektivave afatgjata të një vendi. Studimet mbi të rinjtë janë studime për të ardhmen të cilat në disa raste mund të na tregojnë më shumë se analizat e detajuara ekonomike

Falë një ekipi të përshtatur mirë dhe të përbërë nga fondacioni Friedrich Ebert dhe një kompani profesionale hulumtimesh, IDRA Research & Consulting në Prishtinë, u krye studimi i parë mbi të rinjtë në një vend i cili është akoma në përpjekje të mëdha për identitetin e tij: Kosova.

Ndoshta kjo nuk është rastësi, sepse për të ardhmen e këtij vendi të vogël, gjendja e gjeneratës së re është e një rëndësie të veçantë. Në Kosovë, pjesa e popullsisë nën moshën 30 vjeç përbën rreth 55% e të gjithë popullsisë. Për rrjedhojë, qëndrimet e kësaj gjenerate të re, dhe padyshim aftësitë dhe zotësitë e saj janë veçanërisht të rëndësishme për vendin. Ky studim mbi të rinjtë paraqet përgjigje të qarta në këtë pikë. Qartazi, gjenerata e re në Kosovë është ambicioze dhe ka pritshmëri të larta për të ardhmen e saj. Ndoshta, optimizmi i tyre është me tepri, por është përsëri mbresëlënëse sa shumë energji harxhon dhe sa shumë shpresë vendos kjo gjeneratë në formimin e të ardhmes së vet.

Të rinjtë e intervistuar janë në dijeni të faktit që gjendja e vendit të tyre është akoma e pasigurtë. Për ta, të gjejnë një punë dhe të kenë një jetë të sigurt në Kosovë është shumë larg të qenit një mundësi e garantuar. Shumë nga të rinjtë joshen nga ideja që të lënë përkohësisht vendin e tyre për një edukim më të mirë dhe një karrierë profesionale në një nga vendet më të zhvilluara Evropiane apo SHBA. Gjithsesi, është e dukshme që ata janë të lidhur me vendin e tyre dhe që i perceptojnë rrënjët e tyre familjare si thelbësore. Ata gjithashtu ndihen shumë borbëllin ndaj nënës dhe babës dhe – në këto kohë të pasigurta – i drejtohen besimit të tyre fetar, ndonjëherë edhe më shumë se vet prindërit e tyre. Por përgjithësisht ata vështrojnë përpara. Nga përgjigjet e tyre, krijohet përshtypja se sa të paduruar mund të bëhen, nëse zhvillimet ekonomike dhe politike në vendin e tyre nuk ecin në mënyrën e shpresuar.

Fondacioni Friedrich Ebert, duke ndjekur shembullin e studimeve mbi të rinjtë të kryera në Gjermani, po kryen studime të njëjta mbi të rinjtë edhe në vendet e tjera të Europës Jug-Lindore. Fondacioni më ngarkoi detyrën e mbikqyrjes së këtij studimi nga pikëpamja shkencore si dhe të garantimit që analizat përkatëse mund të krahasoheshin me njëra-tjetrën. Në këtë mënyrë është e mundur jo vetëm ndërtimi i një portreti të të rinjve në Evropën Lindore, por edhe krijimi i një pamje të ndjeshme të potencialit për zhvillim të këtyre vendeve. Institucionet ekonomike dhe arsimore si edhe organizatat e përfshira në fushën e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare

këshillohen të shqyrtojnë gjetjet e këtyre studimeve dhe të nxjerrin rrjedhime prej tyre. Nëse kjo nuk ndodh, ekziston kërcënimi i një ftohje ndërmjet gjeneratës së re dhe forcave të mirëvendosura në vend, gjë e cila nuk ka qenë asnjëherë e mirë për zhvillimin e mëtejshëm të çdo vendi.

Dëshiroj të përgëzoj Fondacionin Friedrich Ebert në Prishtinë për përkushtimin e treguar si dhe hulumtuesit e IDRA-s për këtë studim të plotë dhe metodologjikisht të shkëlqyer, i cili do të vendosë standarde për hulumtimet në vijim.

Përmbledhje

Familja dhe jeta shoqërore

- Një pjesë a madhe e të rinjve të moshës 16-27 vjeçare në Kosovë deklarojnë se jetojnë me prindërit e tyre. Pjesa më e madhe e të rinjve që e lëshojnë vonë “folenë familjare” veprojnë kështu sepse mendojnë që është zgjidhja më e përshtatshme për familjen e tyre. Ky numër i konsiderueshëm i të rinjve që jetojnë me prindërit shpjegon edhe ndikimin e madh që ka familja në jetën e përditshme të rinisë Kosovare.
- Figura e babait është padyshim figura që ka më së shumti ndikim tek të rinjtë pavarësisht gjinisë apo vendbanimit (urban kundrejt rural).
- Të rinjtë Kosovarë mendojnë se meshkujt dhe femrat duhet të martohen në një moshë relativisht të re, 24 vjeç për femrat dhe 26 vjeç për meshkujt, dhe në masë të gjerë e shikojnë të ardhmen e tyre të martuar me familje relativisht të madhe. Rreth 59% e tyre dëshirojnë të kenë tre ose më shumë fëmijë.
- Personaliteti është tipari më i rëndësishëm në zgjedhjen e bashkëshortit apo bashkëshortes. Tipare të tjera me rëndësi të madhe janë edhe (të renditura): Përkatësia fetare, Miratimi i familjes, Interesat e përbashkëta dhe Arsimiti. Virgjëria konsiderohet gjithashtu një faktor i rëndësishëm.
- Rinia Kosovare ka besim të plotë tek familja. Familja është institucioni social më i besuar, duke u vlerësuar me 98 pikë në një shkallë 0-100 ku 0 do të thotë “Aspak besim” dhe 100 do të thotë “Besim i plotë”. Drejtuesit fetarë gjithashtu janë shumë të besueshëm si nga të rinjtë shqiptarë dhe nga ata serbë të Kosovës.
- Të pyetur se si do ta mirëprisnin njëri-tjetrin si fqinjë, të rinjtë shqiptarë dhe serbë të Kosovës hezitojnë ta pranojnë njëri-tjetrin. Të dyja këto grupe të rinjsh shprehin nivele të larta (dhe të ngjashme) hezitimi për idenë e të paturit si fqinj, një çift homoseksualësh. Të rinjtë serbë të Kosovës nuk do të ndiheshin mirë të kishin një familje nga SHBA apo nga Evropa Perëndimore për fqinj. Përkundrazi të rinjtë shqiptarë të Kosovës do të mirëprisnin fqinjë të këtyre kombësive.
- Vlerat e konsideruara si më të rëndësishmet nga rinia Kosovare janë Altruizmi, Toleranca dhe Korrektësia. Harta e vlerave është ndryshe për të rinjtë serbë të Kosovës – tri vlerat më të rëndësishme për këtë grup janë Dinjiteti vetjak, Prestigji në shoqëri dhe Pasurimi.
- Rreth 91% e të rinjve Kosovarë deklarojnë që i përkasin fesë myslimane por vetëm 26% e tyre shprehen se e praktikojnë fenë e tyre rregullisht. Praktikimi i fesë është më i lartë tek meshkujt sesa tek femrat.
- Pavarësisht faktit që jetojnë në një zonë që ka përjetuar konflikt, 90% e të rinjve shqiptarë të Kosovës ndihen të sigurt në zonën ku jetojnë. Situata është krejt e kundërt për të rinjtë serbë të Kosovës me një pjesë prej 60% që deklarojnë të ndihen të pasigurt në zonën ku jetojnë.
- Ndërsa 33% e të rinjve shqiptarë të Kosovës shprehen se janë ndjerë të diskriminuar ndonjëherë ose më shpesh, situata është më e keqe për të rinjtë serbë të Kosovës. Një shumicë prej 78% e këtij grupi deklarojnë se janë ndjerë të diskriminuar. Të rinjtë serbë të Kosovës përmendin Përkatësinë Etnike dhe Fetare si arsyt kryesore për trajtimin diskriminues të përjetuar.

- Pothuajse 1 në 3 të rinj (29%) dëshiron të zhvendoset diku tjetër në Kosovë dhe pothuajse 1 në 2 të rinj (55%) do të emigronte jashtë vendit. Arsytet për të emigruar përfshijnë: dëshirën për të përmirësuar standardin e jetesës, aspiratën për të pasur shkollim më cilësor dhe mundësi më të gjera për punësim.
- Pavarësisht problemeve, të rinjtë Kosovarë janë gjerësisht optimistë për të ardhmen e tyre. Një shumicë prej 87% beson se gjërat do të përmirësohen në 10 vitet e ardhshme.
- Nëse do tu jepej mundësia, rreth 61% e të rinjve Kosovarë do të preferonin të edukoheshin jashtë vendit.
- Sipas studentëve dhe nxënësve të Kosovës, fenomeni i blerjes së notave dhe provimeve në fakultet apo shkollë është i përhapur. Ky mendim, edhe pse është më shumë një perceptim se sa një përvojë personale e drejtpërdrejtë, përbën një çështje shqetësuese për sistemin e arsimit në Kosovë.
- Ndjekja e kurseve private është një përvojë e përhapur për të rinjtë pavarësisht nivelit të arsimit të ndjekur (shkollë e mesme apo universitet). Pothuajse 47% e studentëve dhe nxënësve pohuan që ndjekin kurse private të një farë lamiye.

Arsimi dhe punësimi

- Shkalla e pjesëmarrjes në shkollë për rininë Kosovare të moshës 16-27 vjeç është relativisht e lartë. Për këtë grupmoshë, afërsisht dy të tretat (66%) vazhdojnë shkollën e mesme, universitetin apo programe pas-universitare.
- Të rinjtë Kosovarë të regjistruar në sistemin arsimor, përgjithësisht janë të kënaqur të shkojnë në shkollë, edhe pse një ditë tipike përshkruhet si “e ngarkuar dhe stresuese”. Pjesa më e madhe e studentëve apo nxënësve në Kosovë deklarojnë të studiojnë deri tri orë në ditë.
- Arsimi është një vlerë e rëndësishme për të rinjtë Kosovarë. Një pjesë dërrmuese prej 92% e nxënësve të shkollës së mesme planifikojnë të vazhdojnë shkollimin universitar.
- Megjithatë aspiratat për arsim janë të larta, niveli i kënaqësisë me sistemin aktual të arsimit është relativisht i ulët. Vetëm rreth 24% janë të kënaqur me të.
- Niveli i punësimit është i ulët ndër të rinjtë e Kosovës. Vetëm 32% e atyre që nuk janë aktualisht në shkollë deklaruan që janë të punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme.
- Administrata publike është sektori më i preferuar për punësim nga të rinjtë aktualisht në shkollë, me rreth 45% e studentëve që shprehën preferencë për këtë mundësi punësimi.
- Të rinjtë Kosovarë mendojnë se Njohjet/Lidhjet, qoftë personale apo politike, janë faktori më i rëndësishëm për të gjetur punë. Rreth 50% e të rinjve i përmendin ato si faktorin kryesor për t'u punësuar.

Demokraci dhe Politikë

- Të rinjtë Kosovarë nuk besojnë se vota e tyre ndikon mënyrën se si drejtohen institucionet nga qeveria vendore apo qendrore. Rreth 51% e të rinjve nuk beson se vota e tyre ndikon qeverisjen në Kosovë. Gjithsesi, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve shfaqin interesim për çështje të politikës në vend (56%).
- Të pyetur rreth bindjeve të tyre politike, nëse anojnë nga Opozita apo nga Qeveria, nëse anojnë nga e Majta apo e Djathta (pavarësisht se sa apo çfarë dinë për këtë), pak më shumë se një e treta e të rinjve (36%) zgjedhin pozicionin Neutral. Rreth 22% e të rinjve nuk e dinë se si ta pozicionojnë veten e tyre në boshtin politik (bindje të majta apo bindje të djathta).
- Ndërsa Televizioni mbetet një burim i rëndësishëm informacioni për zhvillimet politike, Interneti po fiton terren, me 66% të të rinjve që deklaruan të marrin informacion mbi politikën nga ky burim.
- Një pjesë e mirë e të rinjve (64%) nuk ndihen të përfaqësuar në politikë. Sipas tyre – “Fitimet personale më tepër se ideali udhëheqin politikanët, duke përfshirë edhe politikanët e rinj në moshë”.
- Në përgjithësi, besimi tek institucionet është i ulët. Mesatarisht të rinjtë i vlerësojnë institucionet dhe grupet me 42 pikë në *Shkallën e Besimit* me vlera nga 0-100 ku 0 do të thotë ‘Aspak besim’ dhe 100 do të thotë ‘Besim i plotë’. Institucionet më të besuara janë Drejtuesit fetarë, Policia dhe deri diku Mediat. Ato më pak të besuara janë UNMIK, Partitë politike dhe EULEX.
- Rinia Kosovare shprehet se ndjehet e shqetësuar për Papunësinë (94%) dhe Rritjen e Varfërisë (92%). Të rinjtë shprehin gjithashtu shqetësim për mundësinë e “Ndarjes së Territorit të Kosovës” (70%). “Ndotja e Mjedisit” është përmendur gjithashtu si një shqetësim i madh (65%).
- Pavarësisht problemeve të perceptuara, të rinjtë shqiptarë të Kosovës janë në përgjithësi optimistë për të ardhmen ekonomike të vendit. Kjo ndryshon për të rinjtë serbë të Kosovës, të cilët shfaqin parashikime të zymta.

Kosova dhe integrimi në BE

- Pavarësisht nga problemet që po kalon Bashkimi European, Rinia Kosovare e mbështet fuqishëm bashkimin me të. Një pjesë e madhe e tyre, 88% mendojnë që Kosova duhet të integrohet në BE.
- Kur u pyetën se kur do të hyjë Kosova në BE, të rinjtë u përgjigjën me shumë optimizëm, rreth 50% e tyre thanë brenda pesë viteve të ardhshme.
- Për shumicën e të rinjve integrimi në BE kuptohet si “lëvizje e lirë dhe liberalizim i vizave”.

Mënyra e Jetesës dhe Koha e Lirë

- Rinia Kosovare kalon një pjesë të mirë të ditës duke konsumuar media – duke parë televizor, duke dëgjuar muzikë dhe duke vizituar rrjetet sociale. Një e re/i ri në Kosovë harxhon mesatarisht 3.5 orë në ditë duke parë televizor.
- Të rinjtë në Kosovë kanë qasje të gjerë në Internet dhe janë përdorues të mëdhenj të rrjeteve sociale. Ata kalojnë mesatarisht 3.5 orë në ditë në Internet (baraz me orët e kaluara duke parë televizor).
- Vlerat e lidhura me “Pamjen e jashtme”, një “Status shoqëror të respektueshëm” dhe “Ushqimin e shëndetshëm” konsiderohen si më në modë nga shumica e të rinjve Kosovarë, duke treguar një qëndrim modern të tyre.
- Tema mbi Seksin konsiderohet përgjithësisht *tabu*, veçanërisht kur diskutohet me prindërit apo me anëtarë të tjerë të familjes.

Hyrje

Studimi Rinia e Kosovës, 2012 është një nismë e Fondacionit Friedrich Ebert në Kosovë e cila u zbatua nga IDRA Research & Consulting.

Ky hulumtim në thellësi ka për qëllim të zbulojë dhe shpjegojë perceptimet, dëshirat, qëndrimet dhe pritshmëritë e rinisë në Kosovë. Hulumtimi prek dimensione të ndryshme të kësaj grupmoshe në mënyrë që të ofrojë një pasqyrë të vizionit dhe të pikëpamjeve të një gjenerate të re. Hulumtimi përbëhet nga dy pjesë:

Pjesa sasiore

Mostra është përfaqësuese për të rinjtë e moshës 16-27 vjeç në Kosovë. Anketa përfshin 1000 të rinj zgjedhur në mënyrë tërësisht rastësore nëpërmjet një metodike specifike kampionimi. Një shtesë prej 80 anketash me të rinj serbë të Kosovës ju shtua mostrës në mënyrë që të krijohej një nëngrup me numër të mjaftueshme për analizë statistikisht domethënëse. Këto intervista shtesë u peshuan kur të dhënat u analizuan në nivel kombëtar; në këtë mënyrë të rinjtë serbë të Kosovës nuk janë mbipërfaqësuar në të dhënat në nivel kombëtar. Nga ana tjetër, kur u bë krahasim ndërmjet etnive peshat nuk u përdorën; dy nëngrupe me madhësi 900 të rinj shqiptarë dhe 130 të rinj serbë të intervistuar u krahasuan.

Anketa u krye gjatë periudhës 1-20 Qershor 2012.

Toleranca e gabimit

Toleranca e gabimit për mostrën kombëtare (N=1000) është $\pm 3.1\%$ me një interval konfidence prej 95%¹.

¹ Teknikisht, një tolerancë gabimi $\pm 3.1\%$ nënkupton që, nëse merren në mënyrë të përsëritur kampione të kësaj madhësie, 95% e tyre do të pasqyronin opinionet e popullatës me pasaktësi jo më të madhe se $\pm 3.1\%$. Kontrolli i rëndësisë statistikore, i cili mban parasysht tolerancën e gabimit është i rëndësishëm veçanërisht kur praqitet analiza e rezultateve për nëngrupe. Këto kontrolle statistikore janë zbatuar në rezultatet e paraqitura në këtë raport.

Pjesa cilësore

Pjesa cilësore e studimit ka për qëllim të sigurojë informacion më të hollësishëm të çështjeve të hulumtuara. Për këtë pjesë, nëntë (9) grupe diskutimi të thelluara u organizuan sipas strukturës së mëposhtme:

Grupet e të rinjve

Nr.	Vendndodhja	Zona	Gjinia	Mosha
1	Prishtinë	Urban	Femra	16-20
2	Prishtinë	Rural	Meshkuj	21-27
3	Prizren	Urban	Meshkuj	16-20
4	Prizren	Rural	Femra	21-27
5	Mitrovicë	Urban	Përzier	21-27

Të rinjtë e përfshirë në politikë

Nr.	Vendndodhja	Urban/Rural	Gjinia	Mosha	Prirjet politike
1	Prishtinë	Urban	Përzier	20-27	Pro-qeverisë
2	Prishtinë	Urban	Përzier	20-27	Pro-opozitës

Të rinjtë serbë të Kosovës

Nr.	Vendndodhja	Zona	Gjinia	Mosha
1	Mitrovicë	Urban & Rural	Përzier	16-20
2	Mitrovicë	Urban & Rural	Përzier	21-27

Grupet e diskutimit në thellësi u kryen në periudhën 5-15 Shtator, 2012.

Pyetësori

Pyetësori përbëhej nga 10 module:

- 1 **Listimi i familjes** - të dhëna demografike të anëtarëve të familjes, siguron që përzgjedhja e të anketuarit është rastësore dhe sipas metodologjisë.
- 2 **Koha e lirë dhe mënyra e jetesës** - stilet e jetës të preferuara nga të rinjtë, aktivitetet në kohën e lirë, shikimi i televizionit, përdorimi i internetit etj.
- 3 **Çështje besimi dhe përkatësie** - familja, miqtë, fqinjët, kolegët, perceptimi mbi tolerancën, vullnetarizimi etj.
- 4 **Familja dhe rrethi shoqëror** - indikatorë të jetës familjare dhe rrethit të miqve.
- 5 **Shqetësime dhe aspirata** - kuptimi i shpresave dhe aspiratave të rinisë Kosovare dhe hartimi i shqetësimeve të tyre kryesore.
- 6 **Çështje arsimit dhe punësimi** - vizioni dhe aspirata e gjeneratës së re në Kosovë në lidhje me mundësitë e arsimit dhe të punësimit.
- 7 **Demokraci dhe politikë** - interesimi në politikë, besimi në institucione, pozicionimi politik etj.
- 8 **Qeverisje dhe zhvillim** - pikëpamjet mbi problemet e shoqërisë Kosovare dhe mendimet mbi të ardhmen.
- 9 **Kosova dhe BE** - mbështetja për integrimin në BE, kuptimi i procesit, impakti i progresit dhe mendime për kohën.
- 10 **Demografi** - edukimi, statusi civil, punësimi dhe indikatorit i mirëqënies.

Kampionimi

Metodika e kampionimit të përdorur është një proces përzgjedhje me disa faza. Përzgjedhja e të anketuarve u krye me tre hapa.


Hapi 1: Përzgjedhja e 100 Njësive Bazë të Kampionimit (NBK) në Kosovë

Si Njësi Bazë të Kampionimit për këtë anketë u përdorën zonat gjeografike të përcaktuara nga qendrat e votimit (QV). Për këtë qëllim u përdor lista e qendrave të votimit për zgjedhjet e vitit 2010 e bërë publike nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Përzgjedhja e QV u shtresëzua sipas rajoneve. Numri total i votuesve të regjistruar në QV shërbeu si tregues për dendësinë e popullsisë në zonë. Metoda e përdorur për përzgjedhje është ajo e probabilitetit në përpjesëtim me madhësinë pa përsëritje ku njësia e masës ishte numri total i votuesve të regjistruar në QV.

Hapi 2: Përzgjedhja e familjes brenda QV – intervistuesit u pajisën me një pikënisje rastësore brenda zonës së QV së përzgjedhur. Duke përdorur metodën e rrugës rastësore intervistuesit përzgjedhën çdo derë të k-të² për të marrë pjesë në sondazh.

Hapi 3: Përzgjedhja e të anketuarit – pasi arrihet të kontaktohet familja e përzgjedhur intervistuesi do të krijojë një listë të anëtarëve të përhershëm të familjes të moshës 16-27 vjeç (mosha e re).

- Nëse familja ka vetëm një anëtar të grup-moshës 16-27 vjeç, intervistuesi do të marr për intervistë anëtarin e vetëm në moshë të re të vendbanimit.



- Nëse familja ka dy apo më shumë anëtarë të grup-moshës 16-27 vjeç, intervistuesi do të marrë për intervistë anëtarin në moshë të re e/ i cila/i ka festuar ditëlindjen e/i fundit.
- Nëse familja nuk ka anëtarë të grup-moshës 16-27 vjeç, intervistuesi do të përpiqet të krijojë kontakt me vendbanimin/derën tjetër të k-të.

Terma të përdorur

Në brendësi të këtij raporti janë përdorur termat “Të rinjtë shqiptarë të Kosovës” që i referohet të rinjve me etni shqiptare dhe “Të rinjtë serbë të Kosovës” atyre me etni serbe.

Termi ‘Rinia Kosovare’ i referohet mostrës totale të anketimit, rinisë shqiptare, serbëve dhe minoriteteve të tjera të Kosovës.

² K u llogarit në përpjesëtim me numrin total të votuesve të regjistruar në qendrën e votimit të përzgjedhur. Në këtë mënyrë, qendrat e votimit më të populluara do të kenë gjasa më të mëdha për përzgjedhje (k), ndërsa qendrat e votimit më pak të populluara gjasa më të vogëla. Kjo qasje siguron që çdo vendbanim i ndodhur në zonën e një qendre votimi ka një mundësi zgjedhje.

Familja dhe Jeta Shoqërore

Shumica e të rinjve deklarojnë se jetojnë me prindërit; për rrjedhojë, ndikimi i prindërve është shumë i rëndësishëm. Figura e babait, megjithatë, ka peshë më të madhe në vendimmarrjen e tyre.

Të rinjtë Kosovarë largohen vonë nga “foleja familjare”: rreth 91% e të intervistuarëve të moshës 18-27 vjeç deklarojnë se jetojnë me prindërit e tyre (Fig. 1.1). Jetesa me prindërit justifikohet me argumentin se është zgjidhja më e përshtatshme për të gjithë familjen (86% e të rinjve të cilët jetojnë me prindërit). Vetëm 12% e të rinjve të këtij grupi do të dëshironin të jetonin vetëm, nëse mundësitë financiare do ta lejonin.

Prindërit sigurojnë jo vetëm strehë por gjithashtu ndikojnë dukshëm në vendimet e rëndësishme që të rinjtë marrin për jetën e tyre. Pjesa më e madhe e të rinjve Kosovarë (71%) deklararon se vendimet e rëndësishme për jetën e tyre i marrin së bashku me prindërit e tyre. Një pjesë tjetër, prej 6%, varen tërësisht nga prindërit kur vendime të tilla duhen marrë. Vetëm 22% e të rinjve të intervistuar deklaruan që i marrin vendimet e rëndësishme vetë. Më shumë të rinjtë meshkuj, në krahasim me të rejat femra, marrin vendime kyçe vetë (28% e meshkujve të rinj krahasuar me 16% e femrave të reja).

Figura e babait duket të ketë ndikimin më të madh në vendimmarrjen e të rinjve pavarësisht gjinisë apo vendbanimit (78% e të rinjve – Fig. 1.2). Vetëm 14% e tyre kërkojnë të udhëhiqen nga nëna. Edhe pse më shumë të reja femra shohin nënën si ndikuese në vendimet e tyre, krahasuar me të rinjtë meshkuj (respektivisht 18% dhe 11%), përsëri babai ngelet figura familjare me më ndikim tek të dy gjinitë. Të rinjtë e zonave rurale dhe urbane nuk tregojnë ndryshim në këtë tipar.

Grupet e diskutimit të thelluar me të rinjtë Kosovarë tregojnë që, ndërsa babai ka një ndikim të pamohueshëm në zgjedhje të rëndësishme në lidhje me profesionin apo edukimin, nëna perceptohet si një këshilluese e problemeve ‘më të lehta’ të përditshme.

–“...Me baban tim flas për universitetin dhe punën, ndërsa me nënën flas për çështje më të lehta...” – Bora, 21, Prizren.

Fig.1.1





Fig.1.2



Perceptimet për të ardhmen formësohen nga tradita – të rinjtë Kosovarë e përfytyrojnë veten e tyre të martuar dhe duke ndërtuar familje të mëdha në një moshë relativisht të re.

Pjesa dërrmuese e të rinjve të intervistuar (89%) e përfytyrojnë veten në të ardhmen, në martesë të lumtur me familjen e tyre. Vetëm 7% e shohin veten duke bashkëjetuar me një partner si dhe një pjesë prej 2% preferojnë të jenë të lirë nga detyrimet familjare apo të partnerit në të ardhmen (Fig. 1.3). Përqindja e atyre që dëshirojnë të kenë familje në të ardhmen është akoma më e lartë tek të rinjtë e grupmoshës 23-27 vjeç, me 92%. Vendbanimi dhe gjinia nuk kanë ndikim në projektimet e statusit martesor të të rinjve Kosovarë.

“Martesa dhe krijimi i familjes është qëllimi kryesor për të gjithë. Edhe kariera dhe pasuria janë pa vlerë nëse nuk arrijnë të plotësosh qëllimin kryesor në fillim. Çfarë kuptimi do të kishte gjithsesi?” – Jeta, 26, Prizren.

Përparësia kryesore e martesës kundrejt bashkëjetesës, sipas shumicës së të rinjve pro martesës (56%), është sepse ajo “rrit përgjegjësinë e bashkëshortëve ndaj njëri-tjetrit” (Fig. 1.3). Një pjesë tjetër prej 17% e këtij grupi beson se martesa rrit “përgjegjësinë e bashkëshortëve për rritjen e fëmijëve” dhe një grup tjetër prej 19% mendon se martesa ka përparësi krahasuar me bashkëjetesën në sytë e shoqërisë Kosovare. Perceptimet rreth përparësisë kryesore të martesës nuk ndryshojnë prej vendbanimit apo gjinisë.


“Në qytetin tim ka disa çifte që bashkëjetojnë por në raste të rralla, ata kanë frikë të ndërmarrin këtë hap pasi konsiderohet si jo e moralshme” – Edin, 17, Prizren.

Përgjithësisht rinia në Kosovë mendon se si meshkujt ashtu edhe femrat duhet të martohen në një moshë të re. Mosha më e përshtatshme për martesë sipas të rinjve Kosovarë është 24 vjeç për femrat dhe 26 vjeç për meshkujt. Çka tërheq vëmendjen është se sipas femrave të reja, mosha e përshtatshme për martesë, është pak më e lartë se ajo e perceptuar nga të rinjtë meshkuj. Femrat mendojnë se mosha më e përshtatshme për martesë për vetë femrat është 24 vjeç (kundrejt 23 vjeç të deklaruar nga meshkujt) ndërsa për gjininë e kundërt është 27 (kundrejt 26 të deklaruar nga meshkujt) (Fig. 1.4).


Perceptimet për moshën e përshtatshme për martesë ndryshojnë ndërmjet të rinjve në zonat urbane dhe atyre në zonat rurale. Siç pritet, të rinjtë e zonave urbane mendojnë që zotimi për martesë si për meshkujt ashtu edhe për femrat duhet të jetë mesatarisht një vit më vonë sesa mosha e perceptuar nga të rinjtë e zonave rurale.

Fig.1.3

Vizioni për të ardhmen
Të gjithë të anketuarit (N=1000)


Fig.1.4

Mosha më e përshtatshme për martesë
Të gjithë të anketuarit (N=1000)



Të rinjtë Kosovarë preferojnë të kenë familje relativisht të mëdha. Të pyetur për numrin e fëmijëve që dëshirojnë të kenë në të ardhmen, 59% shprehen se do të dëshironin tre ose më shumë fëmijë (Fig. 1.5). Një pjesë tjetër prej 38% shprehën dëshirën për dy fëmijë. Nuk ka ndryshime në numrin mesatar të fëmijëve të dëshiruar nga të rinjtë e zonave urbane apo rurale. Këto ndryshime janë të vogla ndërmjet të rinjve të dy gjinive (të rinjtë meshkuj preferojnë të kenë mesatarisht famije pak më të mëdha në numër sesa të rejat femra).

Preferencat për gjininë e fëmijëve, për rininë Kosovare, priren të anojnë drejt meshkujve. Numri mesatar i fëmijëve meshkuj të dëshiruar është 1.56, i cili është pak më i lartë se numri mesatar i fëmijëve femra të dëshiruar, 1.34 (Fig. 1.6). Ndërsa femrat nuk tregojnë preferencë për gjininë e fëmijëve të tyre, të rinjtë meshkuj preferojnë djem.

Sipas grupeve të diskutimit në thellësi, meshkujt preferohen kundrejt femrave sepse meshkujt mendohen të ofrojnë siguri në aspekt të mirëqënies ekonomike të prindërve në moshë të thyer. Ekziston gjithashtu një ndjenjë e “ruajtjes së identitetit familjar dhe të rrënjëve të saj”, të cilat perceptohen se mund të bëhen vetëm nga meshkujt.

–“Kjo është një shoqëri e dominuar nga meshkujt; njësoj si në të kaluarën, njerëzit vazhdojnë të preferojnë djemtë më shumë se vajzat. Prindërit vazhdojnë të mendojnë se djemtë janë siguri për mirëqënien e tyre në të ardhmen dhe ruajtës të rrënjëve familjare” – Blerim, 24, Prishtinë.

–“Sipas traditës, djali më i vogël i familjes është i detyruar të kujdeset për prindërit; për sa kohë që tradita jeton, gjendja do të jetë e njëjtë.” – Ardian, 25, Prishtinë.

Fig.1.5


Numri i fëmijëve të dëshiruar*Të gjithë të anketuarit (N=1000)*

Fig.1.6

		Numri i fëmijëve të dëshiruar (mesatarja)	Numri i vajzave të dëshiruara (mesatarja)	Numri i djemve të dëshiruar (mesatarja)
Gjinia	Të gjithë të anketuarit	2.90	1.34	1.56
	Meshkuj	2.98	1.29	1.69
	Femra	2.80	1.40	1.40
Zona	Urban	2.88	1.36	1.52
	Rural	2.91	1.32	1.60

Tipare të rëndësishme që kërkohen tek bashkëshort(i/ja) përfshijnë Personalitetin, Interesat e përbashkëta dhe Arsimitin; por gjithashtu Përkatësinë fetare, Miratimin e familjes dhe Virgjërinë.

Te rinjve ju kërkua të vlerësonin në një shkallë nga 1 deri në 10, ku vlera 1 do të thotë “Shumë e rëndësishme” dhe vlera 5 do të thotë “Aspak e rëndësishme”, ndikimin e disa faktorëve në zgjedhjen e bashkëshortit apo bashkëshortes. Për lehtësi paraqitje, vlerësimet u shndërruan në një shkallë me vlera nga 0-100 ku 0 do të thotë “Aspak e rëndësishme” dhe vlera 100 do të thotë “Shumë e rëndësishme”³.

Me përjashtim të “Prejardhjes krahinore”, të gjithë faktorët e tjerë perceptohen si të rëndësishëm në zgjedhjen e bashkëshortit/es, duke u vlerësuar me më shumë se 50 pikë në shkallën e rëndësisë. Megjithatë, disa faktorë janë më të rëndësishëm se të tjerët. Personaliteti (87 pikë), Përkatësia fetare (84 pikë), Interesat e përbashkëta (83 pikë), Miratimi i familjes (83 pikë) dhe Arsimiti (80 pikë) janë faktorët me më ndikim në zgjedhjen e bashkëshortit apo bashkëshortes (Fig. 1.7). Virgjëria (75 pikë) dhe Gjendja ekonomike (56 pikë) vijojnë në rëndësi. Prejardhja krahinore (45 pikë) konsiderohet si faktori me më pak ndikim.


“Miratimi i familjes është shumë i rëndësishëm kur vendos të martohesh. Për shembull prindërit e mi nuk do të pranonin kurrë nëse unë do të martohesha me një burrë të një kombësie apo besimi tjetër” – Vjollca, 18, Prishtinë.

“Katolikët janë shumë ndryshe dhe kur martohesh me një nga ata të kërkojnë të ndryshosh besimin. Unë jam rritur kështu... Unë nuk mund të ndryshoj dhe të mendoj tërësisht ndryshe” - Fatmire, 20, Prishtinë.


Rëndësia e perceptuar e faktorëve të shqyrtuar ndryshon bazuar në gjininë e të anketuarve (Fig. 1.8). Ndërsa Mirëqënia perceptohet si një faktor deri diku i parëndësishëm për të rinjtë meshkuj (duke u vlerësuar me një vlerë më të ulët se 50 pikë në shkallën e rëndësisë), ky është faktor relativisht i rëndësishëm për të rejtat femra (63 pikë). Gjithashtu Përkatësia fetare, Miratimi i familjes, Interesat e përbashkëta dhe Prejardhja krahinore janë vlerësuar si më të rëndësishme nga femrat krahasuar me meshkujt. Nga ana tjetër, meshkujt e rinj i japin më shumë rëndësi Virgjërisë dhe Pamjes së jashtme.

Fig.1.7

Rëndësia e faktorëve në zgjedhjen e bashkëshortit/es
Të gjithë të anketuarit (N=1000)


Fig.1.8

Rëndësia e faktorëve në zgjedhjen e bashkëshortit/es
Sipas gjinisë



³ Një vlerësim prej 50 pikësh në shkallën e rëndësisë do të thotë që faktori nuk konsiderohet as i rëndësishëm, as i parëndësishëm.

Nje analizë e ndërthurur e gjinisë dhe vendbanimit tregon ndryshime domethënëse ndërmjet katër nëngrupeve: femrat urbane, femrat rurale, meshkujt urban dhe meshkujt rural (Fig. 1.9). Ndryshimet janë domethënëse veçanërisht në perceptimin e rëndësisë të Pamjes së jashtme, Gjendjes ekonomike, Virgjërisë dhe Prejardhjes krahinore.

Pamja e jashtme e bashkërodit/es konsiderohet më shumë e rëndësishme për meshkujt e zonave rurale duke u vlerësuar me 73 pikë kundrejt vlerësimit të atyre në zonat urbane prej 67 pikësh. Gjendja ekonomike konsiderohet e rëndësishme veçanërisht për femrat rurale të cilat e vlerësuan këtë faktor mesatarisht me 65 pikë, kundrejt 61 pikë për femrat urbane. Ndërsa Virgjëria konsiderohet si faktor i rëndësishëm veçanërisht për meshkujt e zonave rurale (81), të ndjekur në perceptim rëndësie nga meshkujt urban (78), femrat rurale (74) dhe femrat urbane (61).

Mesatarisht të rinjtë serbë të Kosovës vlerësojnë si më të rëndësishëm, krahasimisht me të rinjtë shqiptar të Kosovës, Personalitetin (95 kundrejt 86), Interesat e përbashkëta (94 kundrejt 83) dhe Pamjen e jashtme (86 kundrejt 68). Çka tërheq vëmendjen është se Përkatësia fetare e bashkërodit apo bashkëshortes vlerësohet akoma më e rëndësishme nga të rinjtë serbë të Kosovës krahasimisht me të rinjtë shqiptarë të Kosovës (mesatarisht 96 pikë në shkallën e rëndësisë nga të rinjtë serbë të Kosovës dhe 83 pikë nga të rinjtë shqiptarë të Kosovës). Nga ana tjetër, Miratimi i familjes dhe Virgjëria theksohen krahasimisht më shumë nga të rinjtë shqiptarë se sa nga të rinjtë serbë (Fig. 1.10).

Fig.1.9





Fig.1.10





Të rinjtë Kosovarë kanë besim tek familjet e tyre, dhe janë mosbesues ndaj njerëzve me besim fetar të ndryshëm apo bindje politike të ndryshme nga të tyret.

Të rinjtë të intervistuar ju kërkua të vlerësojnë në një shkallë nga 1 në 10 besimin që ata kanë ndaj disa grupeve të ndryshme në shoqëri, ku 1 do të thotë “Aspak besim” dhe 10 do të thotë “Besim i plotë”. Për lehtësi paraqitje vlerësimet u shndërruan në një shkallë nga 0-100, ku 0 do të thotë “Aspak besim” dhe 100 do të thotë “Besim i plotë”⁴.

Familja dhe Të afërmit janë institucionet sociale më të besuara për rininë Kosovare duke u vlerësuar respektivisht me 98 dhe 80 pikë në shkallën e besimit (Fig. 1.11). Udhëheqësit fetar vijnë me 73 pikë, duke u vlerësuar më shumë se Miqtë, të cilët janë vlerësuar mesatarisht me 67 pikë. Grupet sociale më pak të besuara janë Njerëzit me besim fetar të ndryshëm (44 pikë në shkallën e besimit) dhe Njerëzit me bindje politike të ndryshme (40 pikë në shkallën e besimit).

Situata me të rinjtë serbë të Kosovës është e ngjashme: gjetjet tregojnë që ata kanë më shumë besim tek Familjet e tyre (99 pikë në shkallën e besimit) dhe më pak besim tek Njerëzit me bindje të ndryshme politike dhe fetare (respektivisht 42 dhe 40 pikë në shkallën e besimit). Megjithatë të rinjtë serbë të Kosovës priren të besojnë dukshëm më shumë tek Fqinjët e tyre (+22 pikë), Drejtuesit fetarë (+19 pikë), Kolegët e punës (+14 pikë) dhe Të afërmit (+9 pikë), krahasimisht me të rinjtë shqiptar të Kosovës.

Çka është me interes për tu cekur, është besimi i të rinjve serbë të Kosovës ndaj drejtuesve fetar. Ky grup është vlerësuar mesatarisht me 91 pikë në shkallën e besimit, pothuajse në të njëjtin nivel besimi treguar ndaj të afërmeve të tyre.

Fig.1.11
Besimi kundrejt grupeve
Të gjithë të anketuarit (N=1000)

Fig.1.12
Besimi kundrejt grupeve
Sipas etnisë


⁴ Ju lutem kini parasysh që një vlerësim prej 50 pikësh në shkallën e besimit do të thotë që grupi as besohet, as nuk besohet.

Ndërsa të rinjtë shqiptarë dhe serbë të Kosovës njëzëri hezitojnë të pranojnë njëri-tjetrin, ata tregojnë nivele të kundërta pranimi ndaj SHBA-ve, Evropës Perëndimore, Ballkanit, Turqisë, Bosnjes dhe familjeve Rome. Çiftet homoseksuale janë njësoj të papranueshëm nga të dyja etnitë.

Në mënyrë që të matej pranimi apo mospranimi i grupeve të ndryshme, të rinjtë ju kërkua të tregonin se si do të ndiheshin në një situatë hipotetike ku një familje me prejardhje nga një grup specifik do të vinte të banonte pranë shtëpisë së tyre. Vlerësimet u matën në një shkallë Likert me vlera nga 1 deri në 5 ku 1 do të thotë “Shumë mirë”, 2 do të thotë “Mirë”, 3 “Nuk më intereson”, 4 “Keq” dhe 5 “Shumë keq”. Për qartësi paraqitje dhe lehtësi krahasimi, vlerësimet u shndërruan në një shkallë me vlera nga 0-100 ku 0 do të thotë “Shumë keq” dhe 100 do të thotë “Shumë mirë”⁵.

Të rinjtë Kosovarë do të ndiheshin mirë nëse një Grup studentësh apo një Çift pensionistësh do të vendoseshin pranë shtëpisë së tyre (u vlerësuan mesatarisht me 72 dhe 70 pikë në shkallën e pranimi – Fig. 1.14.). Po e njëjta ndjesi pozitive do të përjetohet në rastin e një familje nga SHBA, një familje nga Evropa Perëndimore, dhe deri diku një familje nga Ballkani (të vlerësuar respektivisht me 69, 67 dhe 64 pikë në Shkallën e Pranueshmërisë). Fatkeqësisht, të rinjtë do të ndiheshin keq në përgjithësi nëse një familje serbe/shqiptare⁶ do të lëvizte afër vendbanimit të tyre. Një Çift homoseksualësh gjithashtu nuk është i pranuar. Të dy këto grupe u vlerësuan respektivisht me 31 dhe 29 pikë në shkallën e pranimi. Të rinjtë urban janë pak më të prirur të pranojnë grupet e studiuara krahasimisht me të rinjtë rural.

Fig.1.13





Fig.1.14



⁵ Mesi i shkallës me vlera nga 0-100 është e barazvlefshme me vlerën 3 të shkallës Likert me vlera 1-5, “Nuk më intereson”.

⁶ Të rinjtë shqiptarë u pyetën për një familje serbe, ndërsa të rinjtë serbë për një familje shqiptare. Shikoni grafikun 1.15 për këto të dhëna.

Pranimi i grupeve specifike ndikohet në mënyrë domethënëse nga etnia (Fig. 1.15). Ndërsa **të rinjtë shqiptarë** të Kosovës janë të gatshëm të pranojnë si fqinj një familje nga SHBA (70 pikë në shkallën e pranimi), **të rinjtë serbë** të Kosovës do të ndiheshin të shqetësuar në të njëjtat rrethana (34 pikë në *Shkallën e Pranueshmërisë*). Mendime të kundërta rreth njerëzve apo familjeve nga SHBA duken si të rrënjosura në interpretime të ndryshme të ndodhjeve aktuale dhe atyre historike.

-“Amerikanët janë të anshëm, ata mbështesin shqiptarët dhe ne kemi vuajtur shumë për shkak të tyre” – Stefan, 23, Mitrovicë.


Një model i njëjtë pranueshmërie vihet re edhe për një familje nga Europa Perëndimore, një familje nga Ballkani dhe një familje Turke apo Boshnjake (Fig. 1.15). Të rinjtë shqiptarë të Kosovës do të ndiheshin mirë nëse një familje e tillë do të vendosej në lagjen e tyre. Përkundrazi, të rinjtë serbë të Kosovës do të ndiheshin keq.

Nga ana tjetër, lëvizja e një familje rome afër vendbanimit të tyre do të pritej deri diku pozitivisht nga të rinjtë serbë të Kosovës (75 pikë në shkallën e pranimi) dhe me mosinteresim nga të rinjtë shqiptarë të Kosovës (50 pikë në *Shkallën e Pranueshmërisë*). Sipas grupeve të diskutimit, duket që paragjykimet e të rinjve shqiptarë të Kosovës kundrejt komunitetit Rom janë zhvilluar si pasojë e një opinionit negativ të trashëguar dhe një ngjyrimi negativ të fjalës Rom (magjup) më tepër se sa ndërveprim i drejtpërdrejtë i të rinjve me këtë komunitet.

- “Nuk dua t’i kem për fqinj. Ata mund të jenë njerëz shumë të mirë apo të këndshëm për të kaluar kohën me ta mirëpo ne kemi gjithë këto paragjykime...Që kur kemi qenë të vegjël çdo gjë e keqe është krahasuar me këtë komunitet” - Erza, 17, Prishtinë.

Të rinjtë shqiptarë sikurse edhe ata serbë të Kosovës do të shqetësoheshin nëse një Çift homoseksualësh do të jetonin afër tyre. Vlerësimet respektive në skenarin e Çiftit homoseksual janë 29 dhe 22 pikë në Shkallën e Pranueshmërisë.

Si të rinjtë shqiptarë të Kosovës sikurse edhe ata serbë do “të ndiheshin keq” nëse një familje nga etnia tjetër – shqiptare në rastin e të rinjve serbë dhe anasjelltas – do të vendosej afër shtëpisë së tyre. Fatkeqësisht, shkalla e pranimi të njëri-tjetrit është e ulët.

Fig.1.15


Altruizmi⁷, Toleranca dhe Korrektesa çmohen si vlerat më të rëndësishme nga rinia Kosovare. Harta e vlerave është ndryshe për të rinjtë serbë të Kosovës, të cilët vlerësojnë më tepër Dinjitetin vetjak, Prestigjin në shoqëri dhe Pasurimin.

Të rinjve të intervistuar ju ofruan tetë vlera sociale dhe ju kërkua të zgjidhnin tri prej atyre që çmonin më shumë.

Dinjiteti vetjak dhe Altruizmi janë dy vlerat më shpesh të përmendura si vlera më e çmueshme (Fig. 1.16). Të rinjtë e intervistuar i përmendën ato si e para vlerë më e rëndësishme respektivisht në 29% dhe 28% të rasteve. Toleranca renditet e treta në shpeshtësi, e përmendur nga 13% e respondentëve, 2.4 herë më pak se Dinjiteti vetjak.

Shpirti konkurrues dhe ai novator janë vlerat më pak të përmendura si më të rëndësishmet nga tetë të vlerësuar, me respektivisht 3% dhe 1% të përgjigjeve (Fig. 1.16).

Në terma të përgjithshëm, rinia Kosovare vlerëson më shumë vlerat e Altruizmit, Tolerancës dhe Korrektesisë. Ato janë përmendur si e para, e dyta apo e treta vlerë më e rëndësishme, respektivisht nga 58%, 52% dhe 43% e të rinjve të intervistuar (Fig. 1.16).

“Harta e vlerave” ndryshon për të rinjtë serbë të Kosovës (Fig. 1.17). Tre vlerat më të çmuara për ta janë Dinjiteti vetjak (56%), Prestigji në shoqëri (16%) dhe Pasurimi (10%). Nga ana tjetër, të rinjtë shqiptarë të Kosovës vlerësojnë Altruizmin (30%), Dinjitetin vetjak (26%) dhe Tolerancën (13%) si më të rëndësishmet.

Fig.1.16

Vlerat më të rëndësishme Të gjithë të anketuarit (N=1000)






Fig.1.17

Vlerat më të rëndësishme

Shqiptarë (N=900)



Serbë (N=130)



⁷ Altruizëm – gatishmëria për të ndihmuar të tjerët.



Të rinjtë e Kosovës janë relativisht pasiv në angazhimin e tyre në punë vullnetare. Aktivitetet e lidhura me pastrimin apo mirëmbajtjen e zonave ku ata jetojnë janë ‘tërheqësit’ më të mëdhenj të vullnetarëve.

Angazhimi në punë vullnetare është i ulët. Vetëm një pesë të rinj të intervistuar (21%) është angazhuar në ndonjë projekt vullnetar gjatë 12 muajve të fundit (Fig. 1.18). Nuk ka ndryshim në nivelin e përfshirjes në punë vullnetare prej gjinisë apo vendbanimit.

Sipas grupeve të diskutimit në thellësi, angazhimi i ulët në punë vullnetare duket të jetë i lidhur me mungesën e iniciativave të organizuara, më tepër se sa me një perceptim negativ apo rezistencë kundrejt vullnetarizmit në vetvete. Secili prej të rinjve që morrën pjesë në grupet e diskutimit pohuan një dëshirë për të marrë pjesë në punë vullnetare për një qëllim të mirë.

Dëshira për t’u ndjerë aktiv është arsyeja kryesore pse të rinjtë përfshihen në punë vullnetare, e përmendur prej 55% e të rinjve aktiv (N=212). Përkushtimi ndaj të tjerëve vijon me 16% të përgjigjeve të këtij grupi.

Të rinjtë e Kosovës deklarojnë se marrin më shumë pjesë në aktivitete të lidhura me pastrimin dhe mirëmbajtjen e zonës ku ata jetojnë. Nga të gjithë të rinjtë e përfshirë në punë vullnetare (N=212), 57% janë përfshirë në Pastrimin e mjediseve publike, 20% në Mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra dhe 18% në Ndërtimin e objekteve publike⁸ (Fig. 1.19).

Fig.1.18

Fig.1.19


⁸ Meqënëse një i ri mund të jetë përfshirë në më shumë se një aktivitet, shuma e përqindjeve të paraqitura mund të kalojë 100%. Ju lutem kini parasysh që kategoritë e paraqitura mund të kenë mbivendosje, thënë ndryshe një i ri i cili ka pastruar mjediset publike mund të ketë ndihmuar gjithashtu në ndërtimin e objekteve publike.

Të anketuarit vetëdeklaruan në masë të madhe, se i përkasin një besimi fetar duke treguar ndërkaj praktikim të moderuar të atij besimi.

Pjesëmarrësit në anketë u pyetën: “Ju personalisht, cilës fe i përkisni, nëse i përkisni ndonjëres?” Të rinjtë të cilët vetëdeklaruan t’i përkisnin një besimi fetar u pyetën më tej lidhur me shpeshtësinë e praktikimit të besimit të tyre. Ata u pyetën: ‘Duke përdorur një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 7, ku 1 do të thotë “e praktikoj shumë rrallë” dhe 7 “e praktikoj rregullisht”, sa shpesh do të thonit se e praktikoni fenë së cilës ju i përkisni?’

Pothuajse të gjithë të rinjtë e intervistuar (99%) deklaruan t’i përkisnin një besimi fetar (Fig. 1.20). Pjesa dërmuese e të rinjve të intervistuar (90%) deklaruan t’i përkisnin fesë Myslimane, 4% Ortodokse, 3% Katolike, 1% Bektashije, 1% një besimi tjetër dhe pjesa e mbetur prej 1% deklaruan që nuk e dinin, ishin ateist ose nuk praktikonin asnjë besim.

Edhe pse pothuajse të gjithë të rinjtë deklarojnë t’i përkasin një besimi fetar, vetëm 27% e praktikojnë besimin rregullisht⁹ (Fig. 1.20), duke dhënë një vlerësim 6 apo 7 në shkallën e shpeshtësisë. Një pjesë tjetër prej 53% e të rinjve besimtarë që praktikojnë besimin e tyre fetar ndonjëherë – dhanë një vlerësim 3, 4 apo 5. Pjesa tjetër prej 20% e të rinjve që i përkasin një besimi fetari e praktikojnë atë rrallë ose vetëm me raste.

Në përgjithësi, praktikimi i besimit fetar është më i lartë tek të rinjtë meshkuj krahasuar me të rejtat femra si edhe tek të rinjtë e zonave rurale krahasuar me ato urbane (Fig. 1.21). Nga katër grupet e dalluara, meshkujt e zonave rurale janë ata që e praktikojnë besimin fetar më rregullisht (30%), të ndjekur nga meshkujt e zonave urbane (28%), femrat rurale (23%) dhe femrat urbane (22%). Krahasimisht, të rejtat urbane prirën ta praktikojnë besimin më rrallë krahasimisht me katër nën-grupet.

Fig.1.20





Fig.1.21




⁹ Siç u shqyrtua edhe në grupet e diskutimit në thellësi, praktikimi i besimit do të thotë të shkosh rregullisht në xhami/kishë, të lutesh, të agjërosh gjatë Ramazanit dhe t’u flasësh të tjerëve për fenë.

Identifikimi me praktikat tradicionale Myslimane dhe Ortodokse është i fortë për të rinjtë shqiptar dhe ata serbë të Kosovës (Fig. 1.22). Respektivisht 95% e të rinjve shqiptar të Kosovës deklaruan t’i përkasin besimit Mysliman, ndërsa 91% e serbve të intervistuar deklaruan t’i përkisnin besimit Ortodoks.

Mesatarisht, të rinjtë shqiptarë të Kosovës e praktikojnë besimin e tyre fetar më shpesh se të rinjtë Serbë. Ndërsa 26% e të rinjve shqiptarë të Kosovës e praktikojnë besimin rregullisht, vetëm 4% e të rinjve serbë të Kosovës bëjnë të njëjtën gjë. Nga dhjetë të rinj shqiptar të Kosovës, mesatarisht dy e praktikojnë besimin fetar rregullisht, gjashtë e praktikojnë ndonjëherë dhe dy të fundit e praktikojnë rrallë. Nga ana tjetër, 9 nga 10 të rinj serb e praktikojnë besimin e tyre vetëm me raste.

Fig.1.22



Të rinjtë Kosovarë bëjnë një jetë shumë sociale.

Pothuajse 87% e të rinjve Kosovarë i përkasin një grupi të caktuar shoqëror ku të gjithë e njohin njëri-tjetrin dhe shpesh dalin bashkë (Fig. 1.24). Përbushja me grupin e tyre shoqëror është e lartë: 87% e të rinjve që i përkasin një grupi shoqëror janë ose shumë të kënaqur ose të kënaqur me grupin e tyre (Fig. 1.24).

Si një vend me një përqindje të lartë popullsie në moshë të re si dhe nivel të lartë papunësie, është gjithmonë e lehtë të gjesh njerëz për t'u shoqëruar. Sipas pjesëmarrësve në grupet e diskutimit në thellësi, të jesh pjesë e një grupi shoqëror është gjithashtu pjesë e kulturës së vendit.

Të rinjtë e zonave rurale priren të jenë pjesë e një grupi shoqëror pak më shumë se të rinjtë e zonave urbane (Fig. 1.25). Me shumë se 90% e rinisë rurale, si meshkuj ashtu edhe femra, janë pjesë e një grupi shoqëror. Këto përqindje janë më të larta krahasuar me ato të rinisë urbane, ku respektivisht 86% e femrave të reja dhe 75% e meshkujve të rinj pohuan që janë pjesë e një rrethi të ngushtë shoqëror.

Fig.1.23





Fig.1.24



Pjesa dërrmuese e të rinjve shqiptarë të Kosovës ndihen të sigurt në zonën ku jetojnë. Situata është krejtësisht ndryshe për të rinjtë serbë të Kosovës.

Në përgjithësi, të rinjtë në Kosovë ndihen të sigurt. Të pyetur se sa të sigurt ndihen nga një sulm i mundshëm fizik apo grabitje e mundshme në zonën ku jetojnë, 88% e të rinjve Kosovar shprehën se ndihen shumë të sigurt ose disi të sigurt (Fig. 1.26).

Ndjesia e sigurisë nuk ndryshon në mënyrë të theksuar prej gjinisë. Megjithatë, të rinjtë në zona rurale ndihen në përgjithësi pak më të sigurt se bashkëmoshatarët e tyre në zonat urbane.

Situata është krejtësisht ndryshe për të rinjtë serbë të Kosovës me një pjesë shqetësuese prej 60% të tyre të cilët ndihen të pasigurt. Krahësimisht, vetëm 38% e të rinjve serbë të Kosovës deklarojnë se ndihen të sigurt (1.5% thonë se ndihen shumë të sigurt dhe 36% ndihen disi të sigurt) kundrejt një pjese prej 90% të të rinjve shqiptar të Kosovës.

“Nuk ka siguri për sa kohë nuk ka lëvizje të lirë... Ka një frikë për sigurinë tonë dhe atë të fëmijëve tanë... çdo ditë... në çdo moment diçka mund të ndodhë” – Andrija, 23, Mitrovicë.

Fig.1.25





Fig.1.26



Ekziston një ndjesi e lartë e diskriminimit tek të rinjtë e Kosovës. Situata është akoma më e keqe për të rinjtë serbë të Kosovës.

Të rinjtë u pyetën nëse janë ndërë ndonjëherë të diskriminuar për shkak të (i) gjinisë (ii) statusit ekonomik (iii) përkatësisë fetare (iv) përkatësisë etnike (v) nivelit arsimor (vi) përkatësisë partiake (vii) prejardhjes krahinore (viii) vendbanimit (ne fshat/qytet).

Rreth 37% e të rinjve në Kosovë janë ndërë të diskriminuar të paktën “ndonjëherë” për ndonjë nga arsyet e pyetura (Fig. 1.30). Përqindja e të rinjve që ndihen të diskriminuar “shumë shpesh” apo “shpesh” është 14%.

Rreth 13% e të rinjve shprehën se janë ndërë të diskriminuar të paktën “ndonjëherë” për shkak të gjinisë së tyre. Një pjesë tjetër prej 15% thanë se janë ndërë të diskriminuar prej statusit ekonomik si dhe 12% janë diskriminuar prej etnisë.¹⁰

Ndjenja e të qenit i/e diskriminuar nuk ndryshon prej gjinisë, e thënë ndryshe, femrat nuk janë ndërë më të diskriminuara krahasimisht me meshkujt (Fig. 1.31).

Ndërsa 33% e të rinjve shqiptarë të Kosovës pohojnë që janë ndërë të diskriminuar të paktën “ndonjëherë”, një numër shumë i madh prej 78% e të rinjve serbë të Kosovës janë ndërë po ashtu të diskriminuar (Fig. 1.31). Pothuajse 46% e këtij grupi e ndiejnë diskriminimin “shumë shpesh” ose “shpesh”. Kjo përqindje është afërsisht katër herë më e madhe krahasuar me atë të të rinjve shqiptar të Kosovës (10%).

Nuk ka ndonjë faktor që mund të veçohet për këtë ndjenjë të lartë e të qenit i/e diskriminuar – të rinjtë serbë të Kosovës ndihen të diskriminuar prej secilit nga faktorët e pyetur. Megjithatë dy arsyet kryesore pse të rinjtë serbë të Kosovës ndihen të diskriminuar janë Etnia dhe Besimi fetar. Nga të gjithë të rinjtë serbë të Kosovës të cilët mendojnë se janë diskriminuar të paktën “ndonjëherë”, 75% janë diskriminuar prej Etnisë dhe 74% prej Besimit.

Fig.1.27





Fig.1.28



¹⁰ Një i anketuar mund të jetë ndërë i/e diskriminuar nga më shumë se një arsye.

Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve Kosovarë dëshiron të lëvizë diku tjetër në Kosovë. Arsyet për ndryshimin e vendbanimit përfshijnë mundësitë për të përmirësuar standardin e jetesës, më shumë larmi kulturore dhe mundësi për një shkollim më cilësor.

Pothuajse një në çdo tre të rinj (29% - Fig. 1.32) është i gatshëm të zhvendoset diku tjetër në Kosovë. “Dëshira për të përmirësuar standardin e jetesës” përmendet si arsyeja parësore përse rinia dëshiron të migrojë (40% e atyre që duan të migrojnë), e ndjekur nga “dëshira për të jetuar në një vend më kozmopolitan” (22% e këtij grupi) dhe “mundësi për edukim më të mirë” (18% e këtij grupi).

Më shumë të rinj nga zonat rurale janë të gatshëm të zhvendosen brenda Kosovës krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre urban (35% kundrejt 22% - Fig. 1.33).

Si të rinjtë nga zonat urbane, ashtu edhe ata nga zonat rurale përmendin dëshirën për të përmirësuar standardin ekonomik të jetesës si shtytën kryesore për migrim brenda Kosovës. Sidoqoftë, dëshira për një edukim më të mirë është një arsye më e rëndësishme për të rinjtë nga zonat rurale. Njëzet e gjashtë përqind (26%) e të rinjve nga zonat rurale dëshirojnë të zhvendosen për mundësi më të mira edukimi krahasimisht me 10% të të rinjve nga zonat urbane. Nga ana tjetër, “dëshira për të qenë më afër njerëzve të afërt”, “dëshira për t’ju larguar konflikteve në qytetin ku jetojnë aktualisht” dhe “mundësitë më të mira për të nisur një biznes” janë arsye të përmendura më shpesh nga të rinjtë e zonave urbane për migrim brenda Kosovës.

Të rinjtë serbë të Kosovës janë më të gatshëm të zhvendosen brenda Kosovës krahasuar me të rinjtë shqiptar (50% kundrejt 29% - Fig. 1.33).

“Përmirësimi i standardit ekonomik të jetesës” është një arsye e përmendur më shpesh nga të rinjtë serbë të Kosovës se nga ata shqiptarë (57% kundrejt 37% e atyre që dëshirojnë të zhvendosen). Nga ana tjetër, “mundësi më të mira edukimi” (21%) dhe “më shumë larmi kulturore” (22%) përmenden më shume si arsye për të migruar nga të rinjtë shqiptarë të Kosovës se sa të rinjtë serbë (respektivisht 11% dhe 17%).

Fig.1.29





Fig.1.30



Një pjesë shqetësuese prej 55% e të rinjve Kosovarë dëshiron të largohet nga vendi. Zvicra është vendi më tërheqës, e ndjekur nga SHBA, Gjermani dhe Britani e Madhe.

Një numër i konsiderueshëm i të rinjve Kosovarë shprehën dëshirën për të emigruar nga Kosova. Një në tre të rinj (34%) ka “shumë dëshirë” të largohet nga vendi. Një pjesë tjetër prej 21% kanë “deri diku dëshirë”, duke e çuar shumën e të rinjve që kanë të paktën “deri diku dëshirë” të largohen nga vendi, në 55%.

Nga të rinjtë që kanë dëshirë të lëvizin nga Kosova (N=548), 50% mendojnë që do të përmirësojnë standardin e tyre ekonomik të jetesës nëse veprojnë kështu. Një pjesë tjetër prej 20% e këtij grupi shpresojnë që do të përfitojnë një edukim më të mirë si edhe 14% të tjerë shohin mundësi më të mëdha punësimi (Fig. 1.31).

Zvicra është zgjedhja e parë ndër ata që dëshirojnë të emigrojnë nga Kosova (33%). Kjo është e lidhur me historikun e emigracionit të vendit pasi një numër i konsiderueshëm Kosovarësh kanë anëtarë të familjes të cilët janë vendosur në Zvicër gjatë dekadave të fundit. SHBA (18%), Gjermani (16%) dhe Britania e Madhe (14%) vijnë si vende të preferuara për emigrim nga të rinjtë Kosovarë.

Të rinjtë meshkuj dëshirojnë të emigrojnë pak më shumë se sa të rejtat femra. Pesëdhjetë e shtatë përqind e të rinjve meshkuj, dëshiron, të paktën deri diku, të lëvizë nga Kosova, krahasuar me 52% e të rejtave femra të intervistuar (Fig. 1.32).

Fig.1.31





Fig.1.32



Të rinjtë serbë të Kosovës dëshirojnë të emigrojnë nga Kosova në të njëjtin nivel si të rinjtë shqiptar (58% kundrejt 54% - Fig. 1.33). Çfarë duhet theksuar është, se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve serbë të intervistuar, 18%, nuk dinte si të përgjigjej apo nuk ju përgjigj pyetjes së emigrimit.

Një pjesë prej 87% e të rinjve serbë të Kosovës që dëshirojnë të emigrojnë përmendën “Përmirësimin e Nivelit të Jetesës” dhe “Mundësi më të Mëdha Punësimi” si arsye kryesore për largimin nga Kosova; një përqindje më e lartë se ajo e të rinjve shqiptar (63%). Mundësia për edukim më cilësor është një arsye e përmendur më shpesh nga të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të emigrojnë në krahasim me ata serbë (Fig. 1.34).

Fig.1.33





Fig.1.34



Pavarësisht problemeve, rinia Kosovare është masivisht optimiste për të ardhmen e saj.

Pjesa dërmuese e rinisë Kosovare (87%) është optimiste rreth të ardhmes afat-mesme (Fig. 1.35). Vetëm 10% mendojnë se situata e tyre nuk do të ndryshojë. Më pak se 1% e të rinjve të intervistuar parasheh një të ardhme të zymtë.


Të rinjtë e zonave urbane janë pak më optimistë rreth të ardhmes së tyre afat-mesme krahasuar me të rinjtë e zonave rurale (Fig. 1.35). Një pjesë prej 90% e të rinjve nga zonat urbane presin përmirësime në 10 vitet e ardhshme krahasuar me 84% e të rinjve nga zonat rurale.

Megjithëse optimist në përgjithësi, të rinjtë serbë të Kosovës shfaqin nivele më të ulëta optimizmi se të rinjtë shqiptar. Ndërsa 89% e të rinjve shqiptarë të intervistuar i shohin me pozitivitet 10 vitet e ardhshme, shifra e të rinjve serbë që ndajnë të njëjtat pritshmëri është 73% (Fig. 1.36). Një pjesë tjetër prej 8% e të rinjve serbë nuk perceptojnë ndryshim, dhe 17% nuk mund të thonë cilin drejtim situata e tyre personale do të marrë, për më mirë apo më keq.

Fig.1.35

Si e shikoni të ardhmen tuaj pas 10 vitesh?

Të gjithë të anketuarit (N=1000)



Sipas zonave Urbane/Rurale





Fig.1.36

Si e shikoni të ardhmen tuaj pas 10 vitesh?

Sipas etnisë



Arsimi dhe Punësimi

Niveli i frekuentimit të shkollës për rininë Kosovare është relativisht i lartë.

Dy të tretat e të rinjve deklaruan që janë aktualisht në shkollë të mesme, universitet apo program master/doktoraturë në kohën që u krye intervista.

Vazhdimi i shkollës varet nga grupmosha: 87% e të anketuarve të moshës 16-18 vjeç, 69% e të anketuarve të moshës 19-22 vjeç dhe 40% e të anketuarve të moshës 23-27 vjeç janë aktualisht të regjistruar në një program edukimi (Fig. 2.1).

Të dhënat tregojnë se të rinjtë e zonave urbane (18-27 vjeç) ndjekin shkollën në numra më të mëdhenj se të rinjtë e zonave rurale (Fig. 2.2). Shtatëdhjetë e shtatë përqind (77%) e të rinjve nga zonat urbane të moshës 19-22 vjeç deklarojnë të jenë aktualisht të regjistruar dhe vijnë shkollën, krahasuar me 62% e të rinjve rural të së njëjtës grupmoshë. 1 në 2 (50%) të rinj të moshës 23-27 vjeç, nga zonat urbane, ndjekin universitetin ose një program masteri apo doktorature, krahasuar me 1 në 3 (32%) të rinj rural të së njëjtës grupmoshë.

Fig.2.1





Fig.2.2




Edhe pse një ditë tipike në shkollë është “e ngarkuar dhe stresuese”, të rinjtë Kosovarë përgjithësisht janë të lumtur të shkojnë në shkollë.

Kur të regjistruarit në një nivel arsimor u pyetën se si ndiheshin ndaj shkollës, 76% deklaruan se ndiheshin “të lumtur” ose “shumë të lumtur” (Fig. 2.3). Për më tepër, vetëm një përqindje shumë e vogël e të rinjve ndihen “të trishtuar” kur shkojnë në shkollë. Më së shumti, 24% e kësaj kategorie të rinjsh ndihet herë mirë dhe herë keq kur janë në shkollë.

Çka përbën interes është se qëndrimi i përgjithshëm ndaj shkollës tek studentët nuk ndikohet nga vendbanimi (urban kundrejt rural), gjinia (meshkuj kundrejt femra) apo etnia (shqiptarë të Kosovës kundrejt serbë të Kosovës).

Qëndrimi i përgjithshëm ndaj shkollës është pozitiv, pavarësisht faktit që 30% e të rinjve që janë në shkollë, e perceptojnë një ditë tipike si “të ngarkuar dhe stresuese”¹¹ 48% si “deri diku të ngarkuar dhe stresuese”, dhe vetëm pjesa tjetër prej 21% e përshkruajnë si “të lehtë dhe pa shumë strese”.¹²

Fig.2.3



¹¹ Ata të cilët e perceptojnë një ditë tipike në shkollë si “shumë të ngarkuar dhe stresuese” ose “të ngarkuar dhe stresuese”.

¹² Ata të cilët e perceptojnë një ditë tipike në shkollë si “shumë të lehtë dhe pa strese” ose “të lehtë dhe pa strese”.

Perceptimi mbi ryshfetet në shkolla është shumë i përhapur.

Të rinjtë të cilët aktualisht frekuentojnë shkollën kanë përshtypjen që është fenomen i zakonshëm për studentët apo nxënësit të paguajnë për të marrë një notë të mirë ose të kalojnë një provim. Rreth 35% e të anketuarve besojnë se notat dhe/ose provimet blihen “shpesh” nga studentët apo nxënësit në universitet apo shkollat e tyre. Një pjesë tjetër prej 32% beson se notat dhe/ose provimet blihen “ndonjëherë”. Vetëm 10% e të anketuarve mendojnë që fenomeni i ryshfetit nuk ndodh në shkollën apo universitetin e tyre. Pjesa e mbetur prej 12% nuk dha një mendim rreth kësaj çështje (Fig. 2.4).

Perceptimi se notat dhe/ose provimet mund të blihen nga studentët apo nxënësit gjendet në të gjitha nëngrupet dhe nuk varet nga institucioni i arsimit (shkollë e mesme, universitet apo master/doktoraturë), gjinia (meshkuj apo femra), vendbanimi (urban apo rural) apo grupmosha (16-18 vjeç, 19-22 vjeç dhe 23-27 vjeç).

Shumë nga pjesëmarrësit në grupet e diskutimit në thellësi gjithashtu deklaruan që blerja e provimeve/notave është një fenomen i zakonshëm në shkollat kosovare.

–“Të gjithë e dinë që blerja e notave është një fenomen i zakonshëm” - Azize, 23, Prishtinë.

Pjesa më e madhe e të rinjve Kosovarë që vazhdojnë shkollën shpenzojnë deri në tre orë në ditë duke studiuar. Dyzet e gjashtë përqind (46%) kalojnë një mesatare prej dy orësh, ndërsa 30% studiojnë nga dy deri në tre orë në ditë. Njëzet e katër përqind (24%) e këtij grupi, deklarojnë të kalojnë më shumë se tre orë në ditë duke studiuar. Mesatarisht, të rejtat femra priren të kalojnë më shumë orë duke studiuar krahasuar me të rinjtë meshkuj (Fig. 2.5).

Fig.2.4

Mendoni se notat/provimet blihen nga nxënësit/studentët në shkollën/universitetin tuaj? Vetëm ata të cilët janë aktualisht në shkollë (N=657)





Fig.2.5

Mesatarisht sa orë studioni në ditë?



Të rinjtë që janë aktualisht në shkollë deklarojnë një investim të lartë në kurse private, pavarësisht nivelit të arsimit.

Pothuajse gjysma e të rinjve të anketuar, që janë aktualisht në shkollë (47%), pohojnë të kenë ndjekur kurse private të njëfarë lloji gjatë vitit të fundit akademik. Pjesa më e madhe e këtyre kurseve private janë “gjuhë të huaja” dhe “lëndët shkencore”. Nga të anketuarit aktualisht në shkollë, 32% kanë ndjekur një kurs gjuhe të huaj jashtë shkolle, ndërsa 14% kanë ndjekur një kurs në lëndët shkencore (Fig. 2.6).

Nuk ka ndryshim statistikiisht domethënës në përqindjet e të rinjve meshkuj dhe të rejave femra që kanë ndjekur kurse private. Megjithatë, kjo ndryshon përsa i përket vendbanimit. Rreth 54% e të rinjve nga zonat urbane të cilët frekuentojnë shkollën, kanë marrë pjesë në kurse private, krahasuar me 40% e të ngjashmëve të tyre nga zonat rurale. Është interesante të vërehet se institucioni i frekuentuar (shkollë e mesme, universitet, master apo doktoraturë) nuk ndikon në prirjen për të ndjekur kurse private.

Te rinjtë që kanë ndjekur një kurs privat (N=308) përmendin si arsyt kryesore: “dëshirën për të përparuar përtej njohurive të dhëna nga programi mësimor” (40% e këtij grupi),” nevojën për shpjegime plotësuese përpos atyre të dhëna në klasë” (35% e këtij grupi), dhe “për të kultivuar talentin në një fushë të caktuar” (11% e këtij grupi – Fig. 2.7).

Lehtësia për të kaluar një provim ose për të marrë një notë më të mirë, nëse personi që jep kurset private është gjithashtu edhe mësimdhënës në shkollë u përmend gjatë grupeve të diskutimit në thellësi, si një arsye tjetër për të ndjekur kurse private.

“Nëse shkon në një kurs privat në shkollë të mesme, ai që të jep kursin do të të jap një notë më të mirë në shkollë...” - Liridon, 23, Prishtinë.

Fig.2.6





Fig.2.7







Pjesa dërrmuese e të rinjve Kosovarë dëshiron të vazhdoj arsimin universitar. Për ata të cilët nuk e kanë vazhduar ose nuk kanë ndërmend ta vazhdojnë, arsyeja kryesore është pamundësia financiare.

Nga të gjithë të rinjtë e intervistuar, del që tre nga katër kanë vazhduar, po vazhdojnë ose kanë ndërmend të vazhdojnë një arsim universitar (Fig. 2.8)

Kjo pjesë është akoma më e lartë për nxënësit e shkollave të mesme, 92% e të cilëve deklarojnë se kanë ndërmend të ndjekin universitetin pasi të përfundojnë shkollën e mesme (Fig. 2.8).

Dëshira për të ndjekur një shkollim universitar nuk ndikohet prej gjinisë (meshkujt kundrejt femrave). Sidoqoftë situata ndryshon kur diskutohet vendbanimi. Ndërsa 82% e të rinjve nga zonat urbane dëshirojnë të ndjekin një arsim universitar, vetëm 69% e atyre nga zonat rurale ndajnë të njëjtën dëshirë (Fig. 2.9).

Të rinjtë shqiptarë të Kosovës dhe të rinjtë serbë ndryshojnë dukshëm në dëshirën për të vazhduar arsimin universitar. Shtatëdhjetë e shtatë përqind (77%) e të rinjve shqiptar të intervistuar kanë kryer, po vazhdojnë ose kanë ndërmend të vazhdojnë universitetin, ndërsa vetëm 32% e të rinjve serbë të Kosovës deklarojnë të njëjtën gjë.

Fig.2.8
A keni vazhduar/keni ndërmend të vazhdoni arsimin universitar?
Të gjithë të anketuarit (N=1000)

Vetëm ata të cilët janë aktualisht në shkollë të mesme (N=284)

Fig.2.9
A keni vazhduar/keni ndërmend të vazhdoni arsimin universitar?
Sipas zonave Urbane/Rurale

Sipas etnisë


Kur u pyetën për arsyet që i shtynjë ose i kanë shtyrë drejt arsimit universitar, pjesa më e madhe e të anketuarve përmendi “zgjerimin e kapacitetit të tyre intelektual” (59%) dhe “rritjen e mundësive për punësim” (54%) si faktorët kryesorë. Pothuajse një në katër të rinj të cilët zgjedhën të ndjekin arsimin e lartë deklarojnë se një nga arsyet e kësaj zgjedhje është “përmbushja e vullnetit të prindërve” (Fig. 2.10).

Arsyet e mësipërme u përmendën shpesh gjatë grupeve të diskutimit në thellësi. Përveç këtyre u përmend edhe që pjesa më e madhe e miqve të tyre vazhdojnë arsimin universitar (vazhdimi i studimeve konsiderohet si diçka shumë në trend/modë dhe e pëlqyeshme) si edhe mundësinë për të njohur dikë dhe për të krijuar një lidhje.

- “Po, është në modë të përfundosh studimet dhe të marrësh një diplomë... Pjesa më e madhe e njerëzve mendojnë se të marrësh një edukim të mirë është e nevojshme edhe pse mundësitë për punësim janë të vogla...” - Ramadan, 27, Prishtinë.

I njëjti grup të rinjsh u pyet gjithashtu për arsyet e zgjedhjes së degës specifike në universitet. Tetëdhjetë e tre përqind (83%) e këtij grupi deklaruan që kanë studiuar apo dëshirojnë të studiojnë një drejtim që e duan vetë, ndërsa vetëm 13% janë ndikuar ose do të ndikohen nga mundësitë e punësimit gjatë zgjedhjes së degës. Një pjesë e vogël prej 3% e këtyre të anketuarve deklarojnë se kanë zgjedhur ose do të zgjedhin një profil ku mendojnë se kanë më shumë shanse që të pranohen në universitet (Fig. 2.11).

- “Unë kam miq të cilët janë shumë të mirë në arte, por ata studiojnë mjekësi sepse nuk shohin një mundësi në arte apo muzikë...” - Agim, 18, Prizren.

Fig.2.10

Arsyet pse keni vazhduar apo keni ndërmend të vazhdoni arsimin universitar
Vetëm ata të cilët kanë vazhduar apo kanë ndërmend të vazhdojnë arsimin universitar (N=749)





Fig.2.11

Zgjedhja e profilit/degës në universitet
Vetëm ata të cilët kanë vazhduar apo kanë ndërmend të vazhdojnë arsimin universitar (N=749)



Pjesa më e madhe e të rinjve të cilët nuk kanë vazhduar apo nuk kanë ndërmend të vazhdojnë universitetin (52%) përmendin “pamundësitë e tyre financiare” për këtë zgjedhje. Vetëm 26% e këtij grupi deklaroi se “nuk ka dëshirë të studiojë” (Fig. 2.12).

Përqindja e të rinjve nga zonat rurale të cilët nuk kanë kryer ose nuk kanë ndërmend të vazhdojnë universitetin për arsye të pamundësive financiare është pak më e lartë se ajo e të rinjve në zonat urbane, nga e njëjta kategori.

Pamundësia financiare për serbët e Kosovës është gjithashtu, arsyeja më e shpeshtë për mosndjekje të universitetit në krahasim me shqiptarët e Kosovës. Sidoqoftë, edhe në këtë rast nuk ka ndryshim në renditjen e arsyeve (Fig. 2.13).

Fig.2.12





Fig.2.13



Rinia Kosovare shfaq nivele të ulta të kënaqësisë në lidhje me cilësinë e arsimit.

Rinia Kosovare tregon një nivel realtivisht të ulët kënaqësie lidhur me cilësinë e arsimit të ofruar në vend. Vetëm 24% deklarojnë të jenë “shumë të kënaqur” ose “të kënaqur”. Pjesa më e madhe (55%) zgjedhën mesin e shkallës së kënaqësisë duke u përgjigjur “deri diku të kënaqur”. Pjesa tjetër (19%) janë qartësisht “të pakënaqur” (Fig. 2.14).

“Unë mendoj që shkollat në Kosovë janë më shumë si një detyrim, dhe nuk i japin shumë njohuri studentëve.” - Sami, 27, Prishtinë.

Është interesante se nuk ka ndryshime statistikisht domethënëse në nivelin e kënaqësisë, ndërmjet rinisë urbane dhe asaj rurale, apo ndërmjet meshkujve dhe femrave.

Kënaqësia me sistemin e arsimit është thelbësisht më e ulët për të rinjtë serbë të Kosovës sesa për ata shqiptarë. Vetëm 1.5% e të rinjve serbë të anketuar janë të kënaqur me sistemin aktual të arsimit krahasuar me 27% e të rinjve shqiptarë.


Sipas pjesëmarrësve në grupet e diskutimit në thellësi, një arsye kryesore për këtë nivel të ulët kënaqësie është mungesa e praktikës apo aplikimit real të materialit në planprogramet shkollore. Sipas dëshmimeve, njohuritë jepen kryesisht në teori dhe pak disiplina apo fakultete ofrojnë praktikë si një aktivitet plotësues të shpjegimeve teorike.

“Mësojmë vetëm teori dhe aspak praktikë... Unë kam studiuar Kimi dhe kam mësuar shumë për anën teorike të eksperimenteve, por në të vërtetë nuk kam kryer asnjë nga këto eksperimente.” – Liridon, 23, Prishtinë.


Fig.2.14

Niveli i kënaqësisë me cilësinë e arsimit në Kosovë

Të gjithë të anketuarit (N=1000)



Sipas etnisë



Nëse do t'u jepej mundësia, pjesa më e madhe e të rinjve Kosovarë do të preferonte të studionte jashtë shtetit.

Rreth 61% e të anketuarve deklarojnë se duan të studiojnë në një shkollë publike apo private jashtë shtetit, nëse u jepet mundësia (Fig. 2.15). Vetëm 25% e të rinjve të intervistuar do të preferonin të studionin në një shkollë publike në Kosovë, ndërsa afërsisht 10% do të preferonin të studionin në një institucion privat në vend.

Sipas grupeve të diskutimit në thellësi, të rinjtë Kosovarë mendojnë se profesorët në institucionet private kanë më shumë durim dhe janë më të prirur të shpenzojnë kohë me studentët, sesa profesorët në institucionet arsimore publike. Sipas dëshmimeve, ndërveprimi i drejtpërdrejtë dhe udhëzimet individuale janë më të rralla në shkollat publike se ato private. Përveç këtyre ndryshimeve, rinia Kosovare nuk bën dallime ndërmjet institucioneve arsimore publike dhe private, veçanërisht kur flitet për cilësinë e planprogramit.

“Kam diplomuar në një universitet privat, por nuk kreu praktikë as aty. Pra cilësia e mësimdhënies është e njëjtë [si në universitetet publike]... Ndryshimi i vetëm është në kohën të cilën një profesor shpenzon me studentët veç e veç, e cila nuk praktikohet në shkollat publike” - Gentiana, 22, Mitrovicë.

Të rinjtë e zonave rurale kanë një preferencë më të madhe për të studiuar në Kosovë krahasuar me ata nga zonat urbane (Fig. 2.16). Vetëm 23% e të rinjve nga zonat urbane do të preferonin të studionin në Kosovë (institucione private apo publike), krahasuar me 46% e të rinjve nga zonat rurale.

Të rinjtë serbë të Kosovës pothuajse refuzojnë të arsimohen në Kosovë, me vetëm 1.5% të cilët përmendën institucionet private të Kosovës si mundësi (Fig. 2.16). Pjesa më e madhe e këtij grupi (59%) nuk shprehu ndonjë preferencë për të studiuar në shkollë në Kosovë apo jashtë.

Fig.2.15

Nëse do t'ju jepej mundësia, ku do të preferonit të studionit
Të gjithë të anketuarit (N=1000)






Fig.2.16

Nëse do t'ju jepej mundësia, ku do të preferonit të studionit

Sipas zonave Urbane/Rurale



Sipas etnisë



Studentët në Kosovë janë të matur në pritshmëritë e tyre të punësimit pas diplomimit. Më shumë se një e treta e atyre të cilët janë të punësuar nuk punojnë në profesionin për të cilët janë arsimuar.

Studentët të cilët aktualisht ndjekin universitetin ose një program masteri /doktorature u pyetën për pritshmëritë e tyre për punësim pas diplomimit. Vetëm 22% e këtyre të anketuarve deklaruan që janë optimist dhe mendojnë se do të gjejnë punë menjëherë pas përfundimit të studimeve të tyre. Nga ana tjetër, 48% e këtij grupi beson që ata do të mund të gjejnë punë pas diplomimit, por pas njëfarë kohe. Pjesa e mbetur prej 30% janë të ndarë ndërmjet atyre të cilët nuk besojnë se do të gjejnë punë shpejt dhe të tjerëve të cilët nuk e dinë nëse do të punësohen ndonjëherë (Fig. 2.17).


Të rinjtë e zonave urbane aktualisht të regjistruar në universitete janë disi më optimistë krahasuar me të ngjashmit e tyre nga zonat rurale për sa i përket mundësive për punësim pas diplomimit. Kështu, vetëm 20% e të rinjve urbanë mendojnë që do 'luftojnë' për një vend pune pas diplomimit, krahasuar me 26% e të rinjve ruralë (Fig. 2.17).

Afërsisht 36% e të rinjve aktualisht në punë, punojnë në një profesion të ndryshëm nga profili që kanë studiuar. Vetëm 29% e të intervistuarve deklaruan të punojnë në profesionin që lidhet me shkollimin e tyre të tanishëm apo të mëparshëm, ndërsa 12% punojnë në një profesion disi të lidhur me arsimimin e tyre. Nga ana tjetër, 18% e të rinjve të punësuar deklaruan të mos kenë ndonjë edukim apo profesion specifik (Fig. 2.18).

Fig.2.17

A mendoni se pas përfundimit të studimeve universitare do të gjeni shpejt punë?

Vetëm ata të cilët janë aktualisht në universitet (N=373)




Vetëm ata të cilët janë aktualisht në universitet Sipas zonave Urbane/Rurale



Fig.2.18

A punoni në profesionin që keni marrë ose po merrni?

Vetëm ata të cilët aktualisht punojnë me kohë të pjesshme apo të plotë (N=221)



Niveli i punësimit tek të rinjtë në Kosovë është shumë i ulët.

Sipas gjetjeve të këtij studimi, niveli i punësimit është shumë i ulët tek të rinjtë Kosovarë. Nga të gjithë të anketuarit, më pak se një e katërta (22%) deklaruan se janë të punësuar në një pozicion me kohë të plotë apo të pjesshme (Fig. 2.19).

Ndër të rinjtë të cilët nuk janë aktualisht në shkollë, përafërsisht vetëm një në tre është i punësuar me kohë të plotë apo të pjesshme. Kjo do të thotë që niveli i papunësisë për këtë nëngrup është 68% (Fig. 2.19).

Të rinjtë serbë të Kosovës të cilët nuk janë të regjistruar në një program arsimor kanë nivele më të larta punësimi (me kohë të plotë apo të pjesshme) krahasuar me ata shqiptarë. Ndërsa 63% e grupit të parë deklarojnë të jenë aktualisht të punësuar, vetëm 28% e të rinjve shqiptarë gëzojnë të njëjtin status (Fig. 2.20).

Fig.2.19





Fig.2.20



Administrata publike është sektori i preferuar i punësimit ndër të rinjtë, pavarësisht gjinisë, vendbanimit apo etnisë.

Puna në administratën publike është forma e punësimit më e lakmuar për rininë Kosovare. Të pyetur se në cilët sektorë apo institucione dëshirojnë të punojnë, 46% e të rinjve shprehën preferencën e tyre për punësim në administratën publike, krahasuar me 28% të cilët preferojnë punësim në sektorin privat. Është interesante të vërehet se 19% e të anketuarve preferojnë të punësohen në institucione ndërkombëtare. (Fig. 2.21).

Më shumë femra (52%) krahasuar me të rinj meshkuj (41%) dëshirojnë një karrierë në administratën publike. Anasjelltas, 34% e meshkujve të rinj preferojnë të punojnë në sektorin privat, krahasuar me 21% të femrave të reja.

Si të rinjtë nga zonat urbane edhe ata nga zonat rurale tregojnë prirje të ngjashme drejt punësimit në administratën publike. Sidoqoftë, të rinjtë urbanë duken të jenë disi më të interesuar të punojnë në institucionet ndërkombëtare krahasuar me ata nga zonat rurale (Fig. 2.22).

Në mënyrë të ngjashme me të rinjtë shqiptarë, të rinjtë serbë të Kosovës shfaqin një preferencë për punësimin në sektorin publik (29%), por ndjekur afër nga sektori privat (26%). Sidoqoftë, në krahasim, përqindja e të rinjve serb që preferojnë sektorin publik është shumë më e ulët se e të rinjve shqiptar (48%). Një tjetër kontrast tregon të rinjtë serbë më të paqartë në preferencat e tyre për një sektor punësimi krahasuar me të rinjtë shqiptar. Njëzet e dy përqind (22%) e të rinjve serbë të intervistuar nuk kanë një ide për sektorin e tyre të preferuar të punësimit, ndërsa, ndër të rinjtë shqiptarë, vetëm 3% u përgjigjën në të njëjtën mënyrë (Fig. 2.22).

Fig.2.21





Fig.2.22



“Njohjet dhe miqtë” janë faktorët më të rëndësishëm për të gjetur një punë, sipas mendimit të të rinjve Kosovarë. Këta faktorë kanë më shumë peshë sesa “aftësia profesionale” apo “niveli i arsimimit”. Të ardhurat dhe siguria në punë janë më të rëndësishme se kënaqësia e marrë nga puna dhe një mjedis miqësor pune.

Rreth 37% e të rinjve të anketuar besojnë se faktori më i rëndësishëm për të gjetur punë janë “njohjet dhe miqtë”. Nëse përfshihen edhe “lidhjet politike”, atëherë rreth 50% e të rinjve përmendin këta faktorë si më të rëndësishmit për të gjetur punë, dukshëm më shumë sesa “aftësia profesionale” (23%) dhe “niveli i arsimimit” (19%) (Fig. 2.23).

Nga ana tjetër, faktori më i rëndësishëm për të pranuar apo refuzuar një ofertë pune është “të ardhurat e siguruar” (Fig. 2.24). Pesëdhjetë e dy përqind (52%) e të rinjve përmendin të ardhurat/rrogën si faktorin e parë të motivimit, ndërsa 30% e tyre besojnë se “Siguria e Vendit të Punës” është arsyeja kryesore për të pranuar apo refuzuar një vend pune. Mesatarisht, “Kënaqësia e marrë nga puna” dhe “Mundësia për të punuar me njerëz që të pëlqejnë” perceptohen si më pak të rëndësishme (respektivisht 13% dhe 5%).

Fig.2.23





Fig.2.24



Demokracia dhe Politika

Rinia Kosovare shfaq skepticizëm të lartë se mund të ndikojë në qeverisje nëpërmjet votës së saj, pavarësisht interesimit domethënës që ajo deklaron në politikën e vendit.

Tek të rinjtë Kosovarë, interesimi në politikën e vendit është i konsiderueshëm, krahasuar me një interesim të moderuar në politikën e Ballkanit dhe interesim të pakët për politikën botërore. Sipas gjetjeve të anketës, rreth 55% e të rinjve deklarojnë se janë “shumë të interesuar” ose “të interesuar” për politikën në Kosovë, me 26% “deri diku të interesuar” dhe 18% “të pa interesuar” për të (Fig. 3.1). Interesimi i të rinjve në politikën e Ballkanit dhe atë botërore është më i dobët, me vetëm respektivisht 27% dhe 23% të të anketuarve që shprehin interes.

“Shumë është folur kohët e fundit për procesin e privatizimit, pastaj të negociatave me Serbinë; këto janë çështje të rëndësishme për ne. Situata në vetvete imponon të ndjekësh lajmet politike” – Shpresa, 24, Prishtinë.

Pavarësisht interesit të konsiderueshëm në politikën kombëtare, të rinjtë besojnë se interesi i tyre ka ardhur duke u zbehur vitet e fundit. Ndaj politikës është përhapur një qëndrim i llojit “të gjithë janë njësoj”, duke shkaktuar kështu skepticizëm më të madh ndaj procesit politik. Për shumë pjesëmarrës në grupet e diskutimit, pozicionimi politik nuk ka dhe aq kuptim tashmë, meqenëse të gjitha partitë kanë qenë në koalicion dhe gjërat nuk kanë ndryshuar.

“Ka qenë një kohë që me shoqërinë ngrinim zërin dhe debatonim për presidentët dhe çështjet politike, por tani mund të shohin që nuk ja vlen; në fund asgjë nuk ndryshon dhe kjo i ka bërë njerëzit më të ndërgjegjshëm që mos të harxhojnë kohën me diskutime të tilla.” – Sami, 28, Prishtinë.

Pjesëmarrja në votime nuk reflekton plotësisht nivelin e interesimit të rinisë Kosovare në politikë. Vetëm 45% e të rinjve të intervistuar të cilët mund të votonin në zgjedhjet e fundit deklaruan se kanë votuar “në të gjitha apo shumicën e zgjedhjeve në të cilat ata mund të votonin” (Fig. 3.2).

Të rinjtë serbë të Kosovës përgjithësisht nuk marrin pjesë në zgjedhjet në Kosovë. Ndërsa 49% e të rinjve shqiptarë të intervistuar të cilët mund të votonin në vitin 2010 deklaruan se kanë votuar në “çdo apo shumicën e zgjedhjeve”, vetëm 9% e të rinjve serbë deklarojnë të njëjtën gjë (Fig. 3.2).

Fig.3.1

Interesimi në politikë Të gjithë të anketuarit (N=1000)





Fig.3.2

Pjesëmarrja e të rinjve në zgjedhje

Vetëm ata të cilët mund të votonin në zgjedhjet e fundit (N=608)



¹³ Zgjedhjet e fundit të përgjithshme dhe lokale në Kosovë nga koha e intervistimit u kryen në Dhjetor 2010. Vetëm ata të anketuar të cilët, në vitin 2010, ishin tetëmbëdhjetë vjeç e sipër, u përfshinë në këtë analizë.

Në përgjithësi, një pjesë domethënëse e rinisë Kosovare nuk beson që me votën e saj mund të ndikoj në qeverisjen e Kosovës. Më shumë se gjysma e të anketuarve (51% të cilët u përgjigjën “pak” ose “aspak”) besojnë se vota e tyre është e parëndësishme për të ndryshuar qeverisjen qendrore (Fig. 3.3), ndërsa vetëm 16% besojnë se vota e tyre ka “shumë ndikim”. Njëzet e tetë përqind (28%) e të rinjve beson se vota e tyre ndikon “deri diku” veprimet e qeverisë.

Besimi se vota e tyre mund të ndikojë në qeverisjen vendore është disi më i lartë, megjithatë 43% e të rinjve përsëri besojnë se vota e tyre është joefektive edhe në këtë nivel qeverisjeje (Fig. 3.3).

Tek të rinjtë serbë të Kosovës, besimi se vota e tyre mund të ndikojë në qeverisje pothuajse mungon tërësisht. Më pak se 5% e tyre besojnë se duke votuar mund të ndikojnë “shumë” ose “deri diku” në mënyrën se si pushteti qendror apo vendor drejton institucionet (Fig. 3.4).

-“Nuk votoj sepse nuk e kuptoj se si vota ime do të ndryshojë gjë. Politikat për ne vendosen tjetërkund” – Stefan, 23, Mitrovicë.

Fig.3.3





Fig.3.4



Televizioni mbetet një burim i rëndësishëm informacioni mbi politikën, por Interneti po dallohet, gjithashtu, si një burim i rëndësishëm.

Televizioni dhe interneti janë dy burimet më të shpeshta të informimit në lidhje me çështje politike. Ndërsa televizioni mbetet një burim i rëndësishëm për lajmet politike (88%), është interesante të vihet re se Interneti nuk mbetet shumë mbrapa, me 66% e të rinjve të cilët e kanë përmendur si burim për lajme politike (Fig. 3.5).

“Çdo familje në Kosovë nga 18:00 deri në 21:00 ka televizorin të ndezur, dhe fëmijët përshtaten me rutinën, që në një farë mënyrë bëhet pjesë e kulturës.” – Elis, 26, Prishtinë.

Burime më të rralla të informimit politik përfshijnë Gazetat, Diskutimet në familje, Bisedat me miqtë dhe Radiot. Gazetat u përmendën nga vetëm 37% e të anketuarve si burim për lajmet politike.

Gjatë grupeve të diskutimit në thellësi, pjesëmarrësit e rinj shprehën shqetësimet mbi politizimin e medias në përgjithësi dhe gazetave në veçanti.

“Kam dëgjuar se shumë drejtues politik janë aksionerë në këto gazeta, kështu që është normale që nuk do na tregojnë anën tjetër të medaljes por vetëm të tyren.” – Liridon, 23, Prishtinë.

Ka ndryshime domethënëse ndërmjet të rinjve shqiptarë dhe atyre serbë përse i përket burimeve politike të përmendura. Diskutimet me miqtë apo në familje janë një burim i rëndësishëm lajmesh politike për të rinjtë serbë, ku 83% të tyre të cilët përmendën këto dy burime. Vetëm 22-23% e të rinjve shqiptarë përmendën të njëjtat burime (Fig. 3.6). Interneti, si burim informacioni, përbën një tjetër ndryshim ndërmjet etnive. Vetëm 24% e serbëve të rinj të Kosovës përmendën Internetin, krahasuar me 74% të shqiptarëve.

“Përqijem të mos harxhoj shumë kohë me politikë, por padyshim ka gjëra të cilat më interesojnë në këtë aspekt. Më shumë flas me familjen time dhe miqtë rreth zhvillimeve politike.” – Janko, 19, Mitrovicë.

Një përqindje shumë e vogël e të rinjve serbë të Kosovës përmend Gazetat dhe Radion si burime informacioni (respektivisht 8% dhe 4%). Për të rinjtë shqiptarë, këto media, edhe pse të përdorura më pak se Televizioni dhe Interneti, mbeten burime domethënëse (respektivisht 39% dhe 19%).

Fig.3.5

**Burimet e informimit në lidhje me zhvillimet politike
Të gjithë të anketuarit (N=1000)**






Fig.3.6

Burimet e informimit në lidhje me zhvillimet politike

Shqiptarë (N=900)



Serbë (N=130)



Anojnë nga Qeveria apo nga Opozita? Anojnë nga e Majta apo nga e Djathta? Një pjesë domethënëse e të rinjve mbajnë qëndrim neutral.

Të rinjve të anketuar ju kërkua të poziciononin mbështetjen e tyre ndaj Qeverisë ose ndaj Opozitës në një shkallë me vlera nga 1 në 10 ku 1 do të thotë plotësisht pro Opozitës dhe 10 do të thotë plotësisht pro Qeverisë. Ata të cilët u pozicionuan në vlerat 1 deri në 4 u grupuan si “Anojnë nga Opozita”, ata të cilët u vendosën në vlerat 5 dhe 6 si “Neutral” dhe ata të cilët u pozicionuan në vlerat 7 deri në 10 si “Anojnë nga Qeveria”.



Deri 36% e të rinjve deklarojnë se janë “Neutral” në këtë drejtim, 32% anojnë nga Opozita dhe 25% anojnë nga Qeveria. Tetë përqind (8%) refuzuan të pozicionoheshin (Fig. 3.7).

Pjesa më e madhe e të rinjve serbë të intervistuar nuk u pozicionua as me Opozitën as me Qeverinë në Kosovë. Rreth 51% e tyre u pozicionuan në zonën neutrale, ndërsa 45% refuzuan tërësisht të përgjigjeshin (Fig. 3.7).

Të rinjve të intervistuar ju kërkua gjithashtu të poziciononin bindjet e tyre politike në një shkallë nga 1 në 7 ku 1 do të thotë “plotësisht Majtas”, 4 do të thotë i/e Qendrës, dhe 7 do të thotë “plotësisht Djathtas”. Atyre ju kërkua të pozicionoheshin në këtë shkallë pavarësisht çfarë dinë ose nëse dinë diçka rreth kontekstit politik të lidhur me të Majtën apo të Djathtën. Ata rinj të cilët u pozicionuan në vlera 1 deri në 3 u grupuan si “Anojnë nga e Majta”, ata të cilët u vendosën në vlerën 4 si “Qendër”, dhe ata të cilët u vendosën në vlerat 5 deri në 7 si “Anojnë nga e Djathta”.

Rreth 22% e të rinjve nuk dinë se si ta pozicionojnë veten në një shkallë të tillë (Fig. 3.8). Një pjesë e madhe e të rinjve u pozicionua në Qendër të shkallës, në zonën “e rehatshme” (36%). Ata të cilët anojnë Majtas ose Djathtas janë pothuajse të barabartë me respektivisht 21% dhe 20%.

Është interesante të shihet se të rinjtë serbë të Kosovës nuk marrin anë edhe kur është fjala për ideologjitë politike. Rreth 65% e të rinjve serbë të intervistuar e perceptojnë veten si të Qendrës, ndërsa 29% nuk e di si të vendosen në spektrin politik.

Fig.3.7

Fig.3.8


Shumica e të rinjve nuk ndihen të përfaqësuar në politikë. “Përfitimet personale më tepër se idealet drejojnë politikanët, përfshirë edhe ata të rinj në moshë”.

Rinia Kosovare nuk ndihet e përfaqësuar në politikë, me rreth 64% e të intervistuarve të cilët deklarojnë të ndihen “pak” ose “aspak” të përfaqësuar në politikë (Fig. 3.9).

Gjatë grupeve të diskutimit në thellësi, të rinjtë e papërfshirë në politikë thonë që edhe politikanët e rinj në moshë nuk i përfaqësojnë ata. Sipas mendimit të tyre, edhe politikanët e rinj drejtohen nga përfitimet personale (punësim, praktikë, bursa, etj.) më tepër se nga idealet politike.

Ky mendim u konfirmua gjithashtu edhe në diskutimet me të rinjtë e përfshirë në politikë. Shumë nga këta thanë se mundësitë e punësimit janë më të mëdha nëse dikush është i përfshirë në një parti politike. Kështu që, ata kontribuojnë “vullnetarisht” në aktivitete politike.

“Kam takuar të rinj të cilët thonë se mënyra e vetme për të gjetur punë është të jesh anëtar i një partie politike; dhe ata u anëtarësuan në një parti politike. Në Gjakovë të gjithë anëtarësohen vetëm për punësim.” – Jeta, 26, Gjakovë.

Shumica e të rinjve (52%) janë “deri diku të kënaqur” me demokracinë në Kosovë, duke shfaqur përsëri një qasje më së shumti asnjansëse. Vetëm 28% e të rinjve të intervistuar deklaruan të jenë “shumë të kënaqur” ose “të kënaqur” me nivelin e demokracisë në Kosovë. Afërsisht një në pesë të rinj shpreh pakënaqësi në këtë drejtim (Fig. 3.10).

Tek të rinjtë serbë të Kosovës, pakënaqësia me nivelin e demokracisë në Kosovë është më e lartë. Rreth 39% e tyre janë të pakënaqur krahasuar me 22% të shqiptarëve të Kosovës. Ndryshimi është më i dukshëm kur krahason kënaqësinë me demokracinë në Kosovë. Vetëm 2% e të rinjve serbë të Kosovës janë të kënaqur, krahasuar me 26% e të rinjve shqiptarë (Fig. 3.10).

Fig.3.9





Fig.3.10



Në përgjithësi të rinjtë shprehin besim të ulët tek institucionet. Deri diku kanë besim tek Drejtuesit fetarë, Policia dhe Media.

Të rinjë ju kërkua të vlerësojnë disa grupe dhe institucione¹⁴ në një shkallë me vlera nga 1 në 10 ku 1 do të thotë 'aspak besim' dhe 10 do të thotë 'besim i plotë'. Për lehtësi prezantimi, vlerësimet u kthyen në një shkallë me vlera nga 0 deri në 100 ku 0 do të thotë 'aspak besim' dhe 100 do të thotë 'besim i plotë'¹⁵.

Grupet dhe institucionet u vlerësuan mesatarisht me 42 pikë në *Shkallën e Besimit*, duke treguar se rinia Kosovare shpreh më shumë mosbesim sesa besim kundrejt këtyre entiteteve.

Drejtuesit fetarë janë ndër grupet më të besuara, duke u vlerësuar me 64 pikë në *Shkallën e Besimit* (Fig. 3.11). Policia vijon me 60 pikë e pastaj Media me 55 pikë. Organizatat joqeveritare janë vlerësuar me 50 pikë. Të gjithë grupet dhe institucionet e tjera u vlerësuan me më pak se 50 pikë, që do të thotë se mesatarisht të rinjtë shprehin më shumë mosbesim sesa besim.

UNMIK, Partitë politike dhe EULEX janë institucionet mesatarisht më pak të besuara nga rinia Kosovare, duke u vlerësuar respektivisht me 26, 28 dhe 25 pikë në *Shkallën e Besimit*.

Përgjithësisht, të rinjtë serbë, shprehin besim të ulët për të gjitha institucionet dhe grupet, me një vlerësim mesatar prej vetëm 24 pikë. Drejtuesit fetarë përbëjnë një përjashtim si për të rinjtë serbë dhe ata shqiptarë, me të rinjtë serbë të cilët shprehin besim pak më të lartë tek ky grup.

-“Drejtuesit fetarë janë të lidhur me partitë politike. Të dy janë të pandashëm, kisha dhe partitë/shteti.” – Nemanja, 21, Mitrovicë.

Fatkeqësisht, Presidenca e Republikës së Kosovës dhe Zyra e Kryeministrit u vlerësuan respektivisht me 5 dhe 6 pikë në *Shkallën e Besimit*, duke treguar mosbesim të plotë (Fig. 3.12).

Fig.3.11





Fig.3.12



¹⁴ Në total, 15 institucione dhe grupe u hulumtuan.

¹⁵ Një vlerësim prej 50 pikësh në *Shkallën e Besimit* do të thotë që këtij grupi nuk ka as besim, as mosbesim (neutral).

Të rinjtë Kosovarë, pavarësisht etnisë, janë më së shumti të shqetësuar për “Papunësinë” dhe “Rritjen e varfërisë”. Ata gjithashtu shprehin shqetësim për mundësinë e “ndarjes së territorit të Kosovës”.

Të rinjtë u pyetën se sa të shqetësuar ndihen në lidhje me disa nga problemet me të cilat po përballen Kosova. Vlerësimet u kryen në një shkallë me vlera 1 në 4 ku 1 do të thotë “shumë i/e shqetësuar”, 2 do të thotë “deri diku i shqetësuar”, 3 do të thotë “pak i shqetësuar” dhe 4 do të thotë “aspak i shqetësuar”¹⁶.

Rinia Kosovare, pavarësisht etnisë, përmend Punësimin dhe Rritjen e varfërisë si dy problemet më të theksuara në shoqëri. Respektivisht, 94% dhe 92% e të anketuarve besojnë se këto dy çështje janë shumë shqetësuese (Fig. 3.13).

Të rinjtë e intervistuar e perceptojnë mundësinë e “Ndarjes e Territorit” si çështjen e tretë më shqetësuese, me 70% “shumë të shqetësuar” dhe 16% “deri diku të shqetësuar” për ndikimin e këtij fakti në shoqëri. Kjo tregon natyrën e ndjeshme të kësaj çështje, e cila është shfaqur se fundmi me zhvillimet në Kosovën e Veriut. Të rinjtë shqiptarë e shikojnë këtë problem si humbje të pjesës veriore të territorit, ndërsa për të rinjtë serbë “Ndarja e Territorit” do të thotë shpërbërje nga Serbia.

“Kam frikë nga asimilimi. Çfarë do të ndodhë, nëse për shembull Beogradi njih pavarësinë e Kosovës? Një mik imi ndryshoi mbiemrin dhe ai nuk ndihet më serb, por kosovar. Unë e kam frikë këtë gjë.” Stefan, 23, Mitrovicë.

Është me interes të theksohet se Ndotja e Mjedisit është përmendur gjithashtu si çështje “shumë shqetësuese” për rininë Kosovare (65%). Me shumë gjasa kjo ndodh prej vizibilitetit që ka patur në mbulimin e mediave dhe axhendën e diskutimit publik gjatë 2012.¹⁷

Fig.3.13




Fig.3.14

Çështje dhe shqetësime për rininë Kosovare - Sipas etnisë					
Shqiptarë (N=900)			Serbë (N=130)		
	Shumë	Disi		Shumë	Disi
Papunësia	95%	3%	Rritja e varfërisë	98%	1%
Rritja e varfërisë	93%	6%	Papunësia	99%	0%
Ndarja e territorit të Kosovës	74%	15%	Moszbatimi me korrektësi i legjislacionit	68%	29%
Ndotja e mjedisit	68%	20%	Pasiguria për vendin e punës	79%	18%
Pasiguria për vendin e punës	64%	22%	Rrezikimi i jetës dhe shëndetit në vendin e punës	75%	19%
Rrezikimi i jetës dhe shëndetit në vendin e punës	59%	23%	Ndarja e territorit të Kosovës	59%	28%
Moszbatimi me korrektësi i legjislacionit	54%	25%	Përhapja e sëmundjeve kanceroze	21%	65%
Përhapja e sëmundjeve kanceroze	51%	23%	Liria e lëvizjes jashtë territorit të Kosovës	51%	35%
Liria e lëvizjes brenda territorit të Kosovës	45%	27%	Liria e lëvizjes brenda territorit të Kosovës	53%	30%
Liria e lëvizjes jashtë territorit të Kosovës	47%	25%	Ndotja e mjedisit	33%	32%
Trafikimet e ndryshme	48%	24%	HIV/AIDS	3%	51%

¹⁶ Për lehtësi, vetëm përqindejt e përgjigjeve “shumë i shqetësuar” dhe “deri diku i shqetësuar” janë përfshirë në grafikun dhe tabelën e paraqitur

¹⁷ Ngjarjet në fabrikën e Ferronikel (e akuzuar për ndotje), dhe problemi i ndotjes së tokës bujqësore janë mbuluar shumë nga media gjatë 2012.

Pavarësisht shqetësimeve që kanë, të rinjtë shqiptarë janë përgjithësisht optimistë për të ardhmen ekonomike të Kosovës. Të rinjtë serbë ndihen ndryshe dhe parashikimet e tyre për ekonominë janë të zymta.

Megjithëse rinia Kosovare mendon se Papunësia dhe Rritja e Varfërisë janë dy çështjet më shqetësuese të çastit, pjesa më e madhe (77%) beson që ekonomia e Kosovës do të përmirësohet në 10 vitet e ardhshme (“do të përmirësohet shumë” ose “deri diku”). Njëmbëdhjetë përqind (11%) e të rinjve nuk presin ndonjë ndryshim të ekonomisë, për mirë ose për keq, dhe vetëm 6% parashikojnë një situatë ekonomike të përkeqësuar në 10 vitet e ardhshme (Fig. 3.15).

Pritshmëritë ekonomike për 10 vitet e ardhshme ndryshojnë dukshëm ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Të rinjtë serbë mendojnë se ekonomia në të ardhmen do të jetë më e zymtë; 49% mendojnë se do të përkeqësohet, ndërsa 18% besojnë se do të mbetet njëloj (Fig. 3.16 në të djathtë). Në të kundërt, 84% e të rinjve shqiptarë të intervistuar janë pozitiv që ekonomia e vendit të tyre do të përmirësohet në vitet në vijim (Fig. 3.16 në të majtë).

Fig.3.15





Fig.3.16



Kosova dhe integrimi në BE

Pavarësisht problemeve brenda Bashkimit Evropian, rinia Kosovare mbështet në masë anëtarësimin në të.

Rinia Kosovare është përkrahëse e zjarrtë e anëtarësimit në BE. Kur u pyetën nëse Kosova duhet të anëtarësohet në BE, rreth 88% u përgjigjen "Po" dhe vetëm 7% e kundërshtuan (Fig. 4.1). Është për tu theksuar se kjo mbështetje qëndron në një kohë kur Evropa është duke kaluar krizë ekonomike dhe debate politike.

Gjendja është krejtësisht ndryshe kur analizohen përgjigjet e të rinjve serbë. Nuk ka pothuajse fare mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në BE, me 56% të cilët e kundërshtojnë atë. Një pjesë tjetër prej 43% e të rinjve serbë nuk dinin ose nuk donin ti jepnin një përgjigje kësaj pyetje (Fig. 4.1).

"Njerëzit janë kundër anëtarësimit në BE sepse ata mbështetën bombardimin e vendit. Ata nuk mund të jenë miqtë tanë. Integrimi në BE do të thotë të heqësh dorë nga dinjteti kombëtar." Stefan, 24, Mitrovicë.

- "Futja në BE nuk është e rëndësishme për ne. Ka çështje më të rëndësishme që janë më domethënëse kështu që ne nuk mendojmë përderisa jemi duke u përballur me shumë probleme." – Ivana, 24, Mitrovicë.

Rreth 70% e të rinjve shqiptarë të Kosovës besojnë se anëtarësimi në BE do të ndihmojë Kosovën të zhvillohet më tej ekonomisht dhe politikisht (Fig. 4.2). Perceptimet e të rinjtë serbë janë krejtësisht ndryshe; një pjesë e madhe prej 74% e të rinjve serbë mendojnë se anëtarësimi në BE do të sjellë faktikisht probleme ekonomike dhe politike në Kosovë.

Ndërsa përgjigjet në hulumtimin sasior sugjerojnë se rinia mendon se anëtarësimi në Evropë do të sillte zhvillime ekonomike dhe politike, grupet e diskutimit në thellësi tregojnë se shumë prej tyre nuk janë të familjarizuar me pasojat e drejtpërdrejta për Kosovën në një proces të tillë. Kur flasin për përfitimet që do të sillte anëtarësimi në BE në një këndvështrim më praktik, pjesa më e madhe e të rinjve përmend liberalizimin e vizave si përfitimin kryesor. Kjo për ta është një lidhje e drejtpërdrejtë, duke thjeshtëzuar kështu të gjitha aspektet ligjore, institucionale dhe ekonomike të procesit.

Fig.4.1





Fig.4.2



Kur do të anëtarësohet Kosova ne BE? Të rinjtë Kosovarë janë më optimistë seç duhet.

Në përgjithësi, ka një optimizëm të lartë tek të rinjtë Kosovarë se vendi i tyre do të futet së shpejti në Bashkimin Evropian. Rreth gjysma e të anketuarve (50%) beson që kjo do të jetë e mundur në pesë vitet e ardhshme. Një pjesë tjetër prej 28% parashikon se kjo do të ndodhë në 10 vitet e ardhshme, dhe vetëm 13% mendojnë që do të marrë më shumë se 10 vjet.

Nga njëra anë, një optimizëm kaq i lartë mund të lidhet me mungesën e informacionit se çfarë përfshin procesi dhe cilat janë kërkesat që duhet të përmbushen nga Kosova. Nga ana tjetër, mund të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i faktit që shumë të rinj ngatërrojnë ose barazojnë procesin e anëtarësimit në BE me atë të liberalizimit të vizave apo lëvizjes së lirë.

-“Nuk besoj që njerëzit kanë mjaftueshëm informacion rreth kushteve dhe rregullave për anëtarësim në BE. Shumë prej njerëzve që njoh mendojnë se anëtarësimi në BE është e njëjta gjë me liberalizimin e vizave.” – Pashtrik, 25, Prishtinë.

Ndërsa të rinjtë shqiptarë të Kosovës janë shumë optimistë për procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE, të rinjtë serbë ndihen krejt ndryshe. Rreth 46% e të rinjve serbë beson që Kosova nuk do të jetë kurrë një anëtare e Bashkimit Evropian. Një pjesë e konsiderueshme e të rinjve serbë të Kosovës (35%) nuk mund të jepte ndonjë vlerësim për këtë çështje. Gjithsesi, rreth 17% e të rinjve të këtij grupi etnik mendojnë se Kosova do të anëtarësohet në BE, por do të duhen më shumë se 20 vite që procesi të kryhet.

Fig.4.3





Fig.4.4



Sipas shumicës së të rinjve, anëtarësimi në BE përkthehet në “Lëvizje të Lirë dhe Liberalizim të Vizave”.

“Lëvizja e lirë dhe liberalizimi i vizave” janë dobithë më shpesh të lidhura me anëtarësimin në BE. Kjo gjë pohohet si nga gjetjet sasiore ashtu edhe nga ato cilësore. Rreth 51% e të anketuarve e përmendën këtë si përfitim të anëtarësimit në BE. Nëse shtohen edhe 29% e të anketuarve të cilët përmendën të gjitha dobithë përfshirë edhe lëvizjen e lirë dhe liberalizimin e vizave, rezulton se rreth 81% e të rinjve besojnë që ky është një përfitim i procesit (Fig. 4.5).

“Tregtia e lirë”, “Lehtësia e qëndrimit në vendet anëtare” dhe “Subvencionet” janë dobi të tjera të lidhura me procesin e integritimit, gjithsesi të përmendura në nivele të ulta.

–“Pasi Kosova të anëtarësohet në BE, mbështetja do të vijë. Shumë nga vendet e BE më pak të zhvilluara marrin ndihmë financiare për zhvillimin e projekteve infrastrukturore.” – Jeta, 26, Prizren.

Është interesante të vërehet se një pjesë prej 55% e të rinjve serbë të Kosovës e lidhin anëtarësimin në BE me të katër përfitimet: “Lëvizjen e lirë dhe liberalizimin e vizave”, “Tregtinë e lirë”, “Lehtësinë e qëndrimit në vendet anëtare” dhe “Ndihmën e subvencioneve”. Një njohje e tillë e efekteve të anëtarësimit në BE sugjeron se të rinjtë serbë nuk i rezistojnë idesë së anëtarësimit në BE në vetvete, por më tepër idesë që Kosova të anëtarësohet në BE (Fig. 4.6).

–“Nuk ka mundësi që Kosova të futet në BE. Ka një grup kushtesh të cilat janë të pamundura të përmbushen. Serbët nuk do ta njohin kurrë si të tillë, kështu që procesi do të vonohet.” – Janko, 23, Mitrovicë.

Fig.4.5

Përfitimet e lidhura me anëtarësimin në BE
Të gjithë të anketuarit (N=1000)




Fig.4.6

Përfitimet e lidhura me anëtarësimin në BE

Shqiptarë (N=900)



Serbë (N=130)



Opinion i të rinjve në lidhje me nivelin e angazhimit të qeverisë në procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE, është i ndarë. Rreth 31% e të rinjve të pyetur besojnë se puna aktuale e qeverisë në afrimin e Kosovës me BE është “plotësisht e mjaftueshme” ose “e mjaftueshme” (Fig. 4.7), 40% përsëri zgjedhin një qëndrim më asnjanes duke u përgjigjur që puna e qeverisë është “deri diku e mjaftueshme”, ndërsa 24% shprehen që është “e pamjaftueshme” ose “tërësisht e pamjaftueshme”.

Pjesa më e madhe e të rinjve serbë (55%) beson se qeveria aktuale në Kosovë po bën një punë “të pamjaftueshme” ose “tërësisht të pamjaftueshme” në procesin e anëtarësimit në BE (Fig. 4.8). Një pjesë prej 42% e të rinjve të këtij grupi etnik nuk dha mendim mbi angazhimin e qeverisë në këtë çështje.

Fig.4.7





Fig.4.8



Mënyra e jetesës dhe Koha e lirë

Rinia Kosovare kalon një pjesë të madhe të ditës duke konsumuar media – duke parë televizor, duke dëgjuar muzikë, duke përdorur rrjetet sociale. Mesatarisht, një i ri kalon 3.5 orë në ditë duke parë televizor. Pothuajse një në tre persona ndjek përditë telenovela.

Të rinjtë u pyetën se sa shpesh përfshiheshin në një sërë aktivitete të kohës së lirë. Përgjigjet tregojnë që koha e tyre e lirë kalohet shumë shpesh duke parë televizor dhe duke dëgjuar muzikë, 79% deklarojnë ti kryejnë këto aktivitete “shpesh”. Aktiviteti i tretë më i zakonshëm është “dalja me miqtë”, me rreth 56% të të rinjve Kosovarë të cilët deklarojnë të bëjnë këtë gjë në kohën e tyre të lirë (Fig. 5.1). Të rinjtë, të cilët nuk janë aktualisht të regjistruar në një shkollë priren të kalojnë më pak kohë me miqtë e tyre. Përveç frekuentimit të shkollës, gjinia dhe vendbanimi ndikojnë gjithashtu në kohën e harxhuar me miqtë. Për femrat rurale të cilat nuk vazhdojnë aktualisht shkollën, kjo përqindje ulët në 32%. Nga ana tjetër, rreth 77% e meshkujve nga zonat urbane, të cilët janë aktualisht në shkollë, deklarojnë se dalin shpesh me miqtë e tyre.

“Praktikimi i sporteve” renditet vetëm i pesti (nga gjashtë të pyetur) në shpeshtësi, me 35% e të rinjve të pyetur të cilët praktikojnë shpesh sport.

Të rinjtë u pyetën për kohën mesatare të kaluar duke shikuar televizor. Rreth 37% e tyre kalojnë nga katër deri në gjashtë orë në ditë përpara televizorit, 49% shpenzojnë nga dy deri në katër orë, dhe pjesa tjetër prej 14% shpenzon më pak se dy orë. Mesatarisht, të rinjtë kalojnë 3.5 orë në ditë përpara televizorit.

Rinia Kosovare preferon programet me muzikë të huaj në televizion (Fig. 5.2). Rreth 45% deklarojnë t’i ndjekin këto programe çdo ditë, dhe 23% thonë se i ndjekin dy deri në tre herë në javë. Programe me muzikë të huaj shikohen më shpesh se programet me muzikë popullore. Lajmet gjithashtu ndiqen nga një përqindje e konsiderueshme (40% i ndjekin lajmet shpesh dhe 23% i ndjekin dy deri në tre herë në javë). Është interesante të vërehet se më shumë se 1 në 3 të rinj shikon përditë telenovela.

Fig.5.1

Sa shpesh kryeni secilën nga këto aktivitete?
Të gjithë të anketuarit (N=1000)





Fig.5.2

Shpeshtësia e ndjekjes së programeve televizive
Të gjithë të anketuarit (N=1000)



Të rinjtë kanë qasje të madhe në Internet dhe janë përdorues të mëdhenj të rrjeteve sociale.

Rinia Kosovare është shumë e lidhur me internetin, dhe rreth nëntë nga dhjetë të rinj të pyetur, deklarojnë të kenë qasje në internet (Fig. 5.3), pavarësisht vendbanimit apo etnisë. Përqindja e lidhjes në internet është 95% për të rinjtë urban dhe 89% për të rinjtë rural (Fig. 5.4). Rreth 92% e të rinjve shqiptarë të Kosovës dhe 86% e të rinjve serbë kanë qasje në internet.

Rrjetet sociale dhe chat-i janë dy arsyt më të përmendura pse të rinjtë përdorin internetin. Respektivisht, 83% dhe 80% e të rinjve përdorin internetin (N=914) sepse pëlqejnë të përdorin rrjetet sociale apo të diskutojnë në “chat” me miqtë, të afërmit etj. Sipas grupeve të diskutimit në thellësi, një prirje e re e qasjes në internet nëpërmjet telefonit mobil ka zgjeruar së tepërmi mundësitë për tu lidhur. Shumë të rinj deklarojnë të përdorin Facebook nëpërmjet telefonit dhe kalojnë rreth 80% të kohës në Internet duke përdorur rrjetet sociale.

“Çfarë kam vënë re është se nëse nuk shkon në kafene dhe nuk përdor Facebook nuk je IN, nuk po shkon me trendet dhe do të mbetesh prapa ne krahasim me të gjithë të tjerët. Nëse nuk shkon sipas këtyre dy prirjeve je jashtë/OUT.” – Albert, 23, Prishtinë.

“Shikimi i videove/dëgjimi i muzikës”, “kërkimi i informacioneve të ndryshme (shkollë/punë/qejf etj.)” dhe “dërgimi i e-maileve” janë gjithashtu arsye të përmendura shpesh pse të rinjtë e përdorin internetin. Secila nga këto arsye është përmendur nga më shumë se gjysma e të rinjve përdorues të internetit¹⁸.

Mesatarisht, rinia Kosovare kalon 3.5 orë në ditë në internet. Një gjetje e tillë u përforcua edhe nga grupet e diskutimit në thellësi. Rinia Kosovare shpenzon mesatarisht 7 orë në ditë ose duke përdorur Internetin ose duke parë televizor.

Fig.5.3





Fig.5.4



¹⁸ Një përdorues Interneti mund të përmendë më shumë se një arsye; kështu që shuma e përqindjeve është më e madhe se 100%.

Vlerat e lidhura me “Pamjen e jashtme”, një “Status shoqëror të respektueshëm” dhe “Ushqimin e shëndetshëm” konsiderohen si më në modë nga shumica e të rinjve Kosovarë.

Të rinjve të intervistuar ju kërkua të vlerësonin popullaritetin e një grupi prej dymbëdhjetë vlerash. Vlerësimet u dhanë në një shkallë nga 1 në 3, ku 1 do të thotë “në modë”, 2 do të thotë “jo aq në modë” dhe 3 do të thotë “jashtë mode”.


Tri prirjet më shpesh të përmendura nga të rinjtë e pyetur përfshijnë: “Të dukesh bukur” (87%), “Të mbarosh arsimin universitar” (86%) dhe “Të jesh i pavarur” (84%) (Fig. 5.5).

Grupet e diskutimit në thellësi treguan që prirjet më të fundit në modë, stili i flokëve dhe aksesoret e bukurisë janë gjithashtu të rëndësishëm. Kur ju përgjigjen se çfarë është në modë, çdo grup u përgjigj “Të dukesh bukur” si qëllimin e parë. Për ta kjo do të thotë se “Të dukesh bukur” është një nevojë për tu pranuar në një rreth shoqëror, për të gjetur një punë dhe për të krijuar një lidhje.

Në mënyre interesante del se edhe “Ushqimi i shëndetshëm” është një trend tjetër popullor ndërmjet të rinjve Kosovarë me 83% të përgjigjeve.

“Angazhimi qytetar” dhe “përfshirja në politikë” nuk janë prirje shumë në modë tek të rinjtë e Kosovës. Ato janë përmendur respektivisht nga 42% dhe 29% e të rinjve. “Pirja e marihuanës” është prirja më pak në modë sipas të rinjve Kosovarë (vetëm 10% e përmendin).

Fig.5.5



Në përgjithësi diskutimet mbi seksin konsiderohen akoma tabu, veçanërisht kur diskutohen me prindërit apo anëtarë të tjerë të familjes.

- “Ato që ja thua një shoqeje, nuk ja thua prindërve, veçanërisht çështje seksi.” - Bora, 21, Prizren.

Rreth 45% e të rinjve të pyetur deklarojnë se nuk kanë kryer marrëdhënie seksuale, 18% kanë kryer marrëdhënie seksuale vetëm me një partner, dhe 13% deklarojnë se kanë patur marrëdhënie seksuale me më shumë se një partner. Pothuajse 1 në 4 të rinj (24%) nuk ju përgjigj pyetjes.

Nga ata të rinj të cilët deklaruan të kenë kryer marrëdhënie seksuale (N=312) vetëm 35% kanë përdorur masa mbrojtëse rregullisht, 34% i kanë përdorur me raste dhe 25% nuk kanë përdorur masa mbrojtëse. Nëse rezultatet ndahen sipas gjinisë, rreth 36% e femrave të cilat kanë kryer marrëdhënie seksuale deklarojnë të mos kenë përdorur asnjëherë masa mbrojtëse, krahasuar me 22% të meshkujve.

Fig.5.6




Fig.5.7

